



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR ”
TË USHTRUAR NË BASHKINË KUÇOVË

TIRANË, KORRIK 2022

Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit
NjA	Njësi Administrative
ShA	Shoqëri Anonime
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
TVSh	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	1-3
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	4-8
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	
II.	HYRJA	
1.	Objekti i auditimit	9-12
2.	Qëllimi i auditimit	
3.	Identifikimi i çështjes	
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
5.	Përgjegjësitë e audituesve	
6.	Kriteret e vlerësimit	
7.	Standardet e auditimit	
8.	Metodat e auditimit	
9.	Dokumentimi i auditimit	
	III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
	-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	13-13
	-Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
	1. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm	13-21
	2.1. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit	21-30
	2.2. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre	30-40
	3. Vlerësimi i raportimit financiar	40-53
	4. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	53-71
	5. Shqyrtim ankese	71-76
	IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	77-88
	V. ANEKSE	89-106

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.256/1, datë 09.03.2022 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 09.03.2022 deri në datën 22.04.2022, në institucionin Bashkia Kuçovë u krye në terren auditimi ÷Financiarë.

Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021 dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, etj.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohet), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 5 akt konstatime dhe 2 akt verifikime. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar nuk janë bërë kundërshti dhe nuk është kërkuar të kryhet takim përmbyllës në ambientet e KLSH. Subjekti ka kthyer përgjigje për njohjen me projektraportin me shkresën nr.256/5, datë 25.07.2022.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a me raportin përfundi mtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm konstatohet se; Bashkia Kuçovë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, nuk është bërë përditësimi i saj duke mos reflektuar ndryshimet strukturore të bëra për periudhën objekt auditimi. Edhe pse janë miratuar regjistrat e riskut, bashkia nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh në njësinë vendore. Nuk janë hartuar programe për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafi si dhe nuk janë planifikuar pozicione me status <i>ðkselentë</i> , si dhe pozicione me status <i>ðGrup i veçantë</i> , ku përfshihen 17 kategori të ndryshme.			Rekomandim: Nga Nëpunësi Autorizues, të meren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, të hartojë dhe të miratoj gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.
2	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm rezulton se; Njësia e Auditit të Brendshëm ka ushtruar veprimtarin e saj me 1 auditues dhe jo me 3 auditues sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 114/2015, ÷Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikë, si dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ÷Për Miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësisë			Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të marrë masa për plotësimin e organikës së Auditimit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me

	<p>të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikë. Nuk është realizuar numri i auditimeve konform planit vjetor të auditimeve dhe planeve strategjike të miratuar dhe nuk janë pasqyruar këto mosrealizime në planet vjetore për vitin 2021, nuk kanë hartuar Kartën e Auditimit, nuk janë çelur as manualisht as elektronikisht dosjet e përhershme të auditimit, raportimi vjetor për vitin 2021 nuk është përgatitur dhe dërguar në DHAB si dhe nuk janë përcaktuar fushat me risk.</p>		<p>ligjin. Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit sipas Manualit AB. Gjithashtu në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Kuçovë.</p>
3	<p>Gjetje nga auditimi:Bashkia Kuçovë nuk ka marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 151,289,512 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Nga kjo vlerë gjatë vitit 2021 është likuiduar vlera 106,747,689 lekë, ose 71% e detyrimit. Por gjatë vitit 2021 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 61,443,991 lekë, duke e çuar vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021 në 105,985,814 lekë, ose në masën 70% të detyrimeve në fillim të vitit buxhetor. Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021, krahasuar me këtë vlerë në fillim të këtij viti ushtrimor është ulur në masën prej 30%. Detyrimet e prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018.</p>		<p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura.</p>
4	<p>Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 mbi kontabilizimi i AAM rezulton se: - Llogaria 210 "Toka, troje, terrene", më 31.12.2020 paraqitet me vlerë 351,104 lekë ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 351,142 lekë e cila përfaqëson vlerën neto të trojeve në administrim e pronësi të Bashkisë Kuçovë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se shtesat janë në vlerën 38 lekë që i korrespondon pronave të regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajoneve të ASHK Kuçovë, por pa vlerë, si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur e analizuar sipas aneksit nr. 3 bashklidhur akt konstatimit. Llogaria 211 "Pyje, Plantacione, kullota" më 31.12.2020 paraqitet me vlerë 0 lekë ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 351,142 lekë e cila përfaqëson vlerën neto të pyjeve në administrim e pronësi të Bashkisë Kuçovë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se shtesat janë në vlerën 1 lekë që i korrespondon pronave të regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajoneve të ASHK Kuçovë por pa vlerë, si rrjedhojë</p>		<p>Rekomandim: Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nënpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (<i>ndërtesa e konstruksione</i>), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (<i>referuar tregut</i>), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (<i>rritje/ulje rivlerësimi</i>), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) ÷Aktive afatgjata materiale ÷ llog.(109) ÷Diferenca nga rivlerësimi. Gjithashtu të ngrëjë një grup pune me specialit të fushës, për</p>

	<p>kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur.</p> <p>Llogaria (212) “Ndërtesa e Konstruksione”, më 31.12.2021 paraqitet me vlerë historike 140,424,536 lekë dhe vlerë neto 105,364,697 lekë që përfaqëson vlerën neto të ndërtesave të objekteve në administrim e pronësi të Bashkisë Kuçovë, pakësimet janë në vlerën 35,059,839 lekë për normën e amortizimit vjetor + amortizimin e akumuluar dhe blerje të krijuara me pagesë në vlerën 9,397,669 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, janë kontabilizuar 61 objekte në vlerën 61 lekë që i korrespondon pronave të regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajonale të ASHK Kuçovë, por pa vlerë, si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur e analizuar aneksit nr. 4 pika nr. 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.</p>			<p>kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Kuçovë, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.</p>
5	<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2021 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej 104,080 mijë lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kuçovë, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat, respektivisht; - vlera 17,493 mijë lekë, i përket subjekteve privat (biznesit i vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore) dhe vlera 86,587 mijë lekë i përket abonentët familiar, e detajuar vlera debitorë paraqitet në aneksin nr.4 pika 2.6 bashkëlidhur projektraportit të auditimit</p> <p>Veprimet e mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 ó “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.</p>			<p>Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kuçovë, bazuar në nenin 70 pika 3 òE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në R.SHö, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 104,080 mijë lekë, duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:</p> <p>Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.</p> <p>Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).</p> <p>Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 òMospagimi i taksave dhe tatimeve.</p>
6	<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Kuçovë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Kuçovë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e</p>			<p>Rekomandim:Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të</p>

<p>qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Kuçovë.</p> <p>Konkretisht për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2021, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 16,589,313 lekë për 621 persona, kanë paguar detyrimet 314 persona me vlerë 9,899,435 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2021 gjithsej 307 persona me vlerë 6,694,192 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kuçovë. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Kuçovë për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Kuçovë të jetë drejtuar ASHK Dega Kuçovë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p>		<p>gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 6,694,192lekë ndaj 307 personave si dhe t<i>a</i> kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Kuçovë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p>
---	--	--

3. Konkluzioni dhe opinionin i auditimit

Në përfundim të auditimit financiar, të ushtruar në Bashkinë Kuçovë, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2021 deri në 31.12.2021, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se, pasqyrat financiare të vitit 2021, paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Bashkisë Kuçovë më 31.12.2021, me përjashtim të disa rasteve të cilat sipas opinionit tonë janë materiale, por jo të përhapura. Nga auditimi i procedurave të planifikimit, realizimit dhe zbatimit të buxhetit është konstatuar se Bashkia Kuçovë, nuk është treguar realiste në planifikimin e buxhetit, kryesisht nga të ardhurat e veta, gjë e cila ka sjellë pasoja në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara, të cilat rezultojnë në masën 33%. Gjithashtu nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi edhe pse gjatë vitit 2021 është likuiduar vlera 107.7 milion lekë, gjatë këtij viti janë krijuar sërish detyrime të reja në vlerën 7.6 milion lekë.

Nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, u konstatuan mangësi sidomos në mos identifikim e risqeve, rishikim dhe përcaktimin e aktiviteteve të kontrollit shtesë për minimizimin e tyre.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduar të Bashkisë Kuçovë për vitin ushtrimor 2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., si dheshënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700 , ISSAI 1705 dhe ISSAI 1200, shprehim një **opinion të modifikuar**¹ (kualifikuar) për llogaritë vjetore të vitit ushtrimor 2021 të Bashkisë Kuçovë, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë përmbledhëse vjetore të konsoliduar të vitit 2021. Këto anomalitë janë të shprehura të baza për opinionin e auditimit.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

¹Opinion i modifikuar, jepet në raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin ÷Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare÷, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të modifikuar (kualifikuar) të auditimit.

Në dhënien e opinionit ne kemi marrë në konsideratë nivelin e materialitetit për shpenzimet, në vlerën 9.5 milion lekë, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Llogaria 26 ÷Pjesëmarrje në kapitalin e vet÷ është pasqyruar më pak për vlerën 307,573,000 lekë në mbyllje të vitit ushtrimor 2021;

- Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” është mbivlerësuar në vlerën 8,556,652lekë në mbyllje të vitit ushtrimor 2021;

- Mos sistemi i se llogarisë (230; 231) ÷Investime÷, për (AAJM/AAM) paraqiten me vlerë 230,167,491 lekë që i përket 10 objekte të viteve paraardhës respektivisht të viteve 2015-2020 të cilat janë marrë në dorëzim nga ana e drejtorisë së PZHT për të cilat nuk është bërë sistemi i tyre nga llog (231) në llogarinë (213),

- Llogaria 210 "Toka, troje, terrene", më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 351,142 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se shtesat janë në vlerën 38 lekë që i korrespondon pronave të regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajoneve të ASHK Kuçovë, por pa vlerë, si rrjedhojë kontabilizimi i AAM nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur.

- Llogaria (212) “Ndërtesa e Konstruksione”, më 31.12.2021 paraqitet me vlerë neto 105,364,697 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, janë kontabilizuar 61 objekte në vlerën 61 lekë që i korrespondon pronave të regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajoneve të ASHK Kuçovë, por pa vlerë, si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kuçovë

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kuçovë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Kuçovë janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 òPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të Auditimit nr.256/1, datë 09.03.2022 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 09.03.2022 deri në datën 22.04.2022, në Institucionin Bashkia Kuçovë u krye auditimi òFinanciarò. Auditimi mbuloi periudhën: prej 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. B.M, (P.G)
2. H.I

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazë rrisku.

Titulli Auditim Financiar
Marrësi Bashkia Kuçovë

1. Objektivat dhe qëllimi.

- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, për të arritur objektivin e këtij auditimit që është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ky projekt auditimi do të shtrihet për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2021 deri në datë 31.12.2021, si dhe ka si fushëveprim zbatimin e rekomandimeve, auditimin e pasqyrave dhe transaksioneve financiare, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimin e brendshëm, realizimin e të ardhurave dhe treguesve buxhetore.

3. Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Kuçovë dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi.

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara në programin e auditimit, si më poshtë:

- Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.
- Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare të vitit 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë.
- Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: (Trajtuar në Opinionin mbi auditimin).

5. Përgjegjësitë e audituesve: (Trajtuar në Opinionin mbi auditimin).

6. Kriteret e vlerësimit.

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

- *Standardet e Auditimit:*
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve në KLSH;
- Manuali mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- *Akte ligjore:*
- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Ligji nr. 139/2015 òPër vetëqeverisjen vendore;
- Ligji nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore;
- Ligji nr. 114/2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, etj.
- *Akte nënligjore*
- VKM nr. 500, datë 14.8.2001 òPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore;
- VKM nr. 187 datë 08.03.2017 òPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, etj.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 òPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim.
- *Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore:*
- Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- Udhëzimi MF nr. 22, datë 30.07.2018 òPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisë të vetëqeverisjes vendore;
- Udhëzimi MF nr.10/1, datë 28.02.2017 òPër përgatitjen e buxhetit vendor, etj.
- Rregullore e Brendshme òMbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH^{së}, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr.85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme òMbi Procedurat e auditimit në KLSH, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH^{së} e ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Kuçovë, etj.

7.Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë ÷Parimet INTOSAI-të ku përfshihet: ISSAI-P-1 ÷Deklarata e Limësö , ISSAI-P-10 ÷Deklarata e Meksikosö; Nivelin e dytë ÷Standardet e INTOSAI-të ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 ÷Parimet bazë të auditimit financiarö, ISSAI 400-499 ÷Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisëö.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”

Gjatë auditimit, ka funksionuar sistemi i mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë, për të marrë siguri të arsyeshme, për dhënien e opinionit:

- Grupi i auditimit, ka vepruar në në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore;
- Grupi i auditimit, në mënyrë individuale dhe kolektive ka patur kompetencën e nevojshme profesionale për të kryer auditimin;
- Grupi i punës, është mbikëqyrur nga Përgjegjësi i Grupit, Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit, për të siguruar që auditimi është kryer në përputhje me standardet përkatëse profesionale.

ISSA 130 “Kodin Etik”

Grupi i auditimit, gjatë punës audituese në terren vepruar në përputhje me Kodin Etik, duke reflektuar:

- Integritet.
- Pavarësi, objektivitet, paanshmëri.
- Ruajtjen e sekretit profesional.
- Kompetencat dhe kujdesin e duhur.
- Sjelljen profesionale.

ISSAI 2315 “Risku”

Gjatë fazës së planifikimit dhe auditimit në terren, është kryer vlerësimi i riskut, si dhe u identifikuan fushat më risk më të lartë, mbi të cilat u fokusua auditimi. Nga Grupi i auditimit u vlerësua RA ($RA=RB \cdot RKB \cdot RMZ$), ku u vlerësua:

- Kuptimi i subjektit dhe mjedisit i tij;
- U identifikua dhe vlerësua risku i brendshëm;
- U vlerësua funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm;
- U përcaktua e rreziku i mos zbulimit;
- U aplikua Modeli i sigurisë, (Më hollësisht të trajtuara në Letrat e punës).

ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”

Nga Grupi i auditimit është përcaktuar sipas zonave të llogarisë niveli i materialitetit, i cili ka rezultuar si sasior, po ashtu edhe cilësor (kryesisht në auditimin e përputhshmërisë);

ISSAI 2500 “Dokumentimi”

Nga Grupi i auditimit është siguruar dokumentimi i gjetjeve të auditimit, duke u bazuar kryesisht në një evidencë të plotë, të saktë, të besuar, të mjaftueshme (*ISSAI/IFPP- 2230*), duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- Mjaftueshmërinë e evidencës së auditimit
- Rëndësia e evidencës së auditimit
- Burimet e evidencës së auditimit
- Llojet e evidencës së auditimit, etj.

8. Metodat (Procedurat) e auditimit.

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5).

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësi e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të riskut të auditimit.

Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista verbale, ka kryer teste kontrolli.

Për arsye se në bazë të vlerësimit sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur (rreth në nivelin mesatar), grupi i auditimit u mbështet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga procedurat thelbësore, si:

Kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi, intervistimi, rporte dhe Informacione, pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm etj..

9. Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e manualeve të auditimit, në Manualin e Auditimit Financiar edhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit. Janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar.

Duke ju referuar të gjitha fondeve, pavarësisht burimit të financimit, përfshirë edhe ndihmën ekonomike, analiza e planit dhe faktit të buxhetit është si vijon:

Planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 682,065,997 lekë, realizimi 600,989,320 lekë, ose në masën 88 %.

Duke zbritur nga shpenzimet totale vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK prej 10,441,832 lekë, shpenzimet faktike totale janë në vlerën 590,547,488 lekë kundrejt 665,872,997 lekë të planifikuara.

Bazuar në këtë vlerë, realizimi i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta të njësisë vendore ka vlerën 197,688,259 lekë lekë, ose në masën 33 % të shpenzimeve totale të planifikuara.

Vlera e raportuar nga Bashkia Kuçovë në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2021 është 11,923,434 lekë, ndërsa vlera e detyrimeve të prapambetura të rakorduar me degën e thesarit dhe pasqyruar në pasqyrat financiare të bashkisë pa njësitë vartëse është 122,386,434 lekë. Duke përfshirë edhe detyrimet e njësisë vartëse, vlera totale e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kuçovë është 124,173,474 lekë, nga e cila vlera prej 1,787,040 lekë i përket njësisë vartëse, ndërsa vlera prej 122,386,434 lekë, bashkisë pa njësitë vartëse.

Megjithëse janë bërë likuidime për llogari të detyrimeve të akumuluar të prapambetura, konstatohet se gjatë vitit 2021 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 75,624,832 lekë, nga e cila vlera 61,443,991 lekë, ose 81% është e krijuar nga të ardhurat e veta, ndërsa vlera 14,180,841 lekë, ose 19 % e totalit nga granti.

Në datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën 17,493,818 lekë.

PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS PIKAVE TË PROGRAMIT

Pika 1. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Kuçovë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 *“Për disa shtesa dhe ndryshime*”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Titulli i gjetjes: *KLSH ka konstatuar se në Bashkinë Kuçovë ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e kërkuar sipas dispozitave ligjore.*

1-Mjedisi i kontrollit. (Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010)-Bashkia Kuçovë, ka ushtruar veprimtarinë e sajë me rregulloren e vitit 2018 rregullore e cila nuk është e protokolluar në Bashkinë Kuçovë por është miratuar nga ish Kryetari i Bashkisë z S.F.

Për vitin 2021 numri i punonjësve dhe niveli i pagave është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 88 datë 16.12.2020 òMbi kategorizimin e nivelit të pagave të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar për punonjësit e bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Kuçovë, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat.

Konstatohet se struktura organizative ka pësuar ndryshime nga viti në vit, ndryshime të cilat janë miratuar me Vendimet respektive të sipërcituara në të cilat janë krijuar shumë drejtori/ sektorë dhe agjenci ku është punësuar një numër i lartë punonjësish në këto sektorë, por të panevojshëm pasi në asnjërin prej tyre nuk janë përcaktuar detyrat konkrete ligjore që do kryej dhe përcaktuar punën e secilës strukturë në veçanti.


Këto drejtori/ sektorë nga ana e tyre nuk kanë hartuar rregullore të veçantë të funksionimit të tyre çka bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, pasi rregullorja aktuale që qarkullon në bashki nuk i ka të përcaktuara detyrat për funksionet e reja që i janë deleguar nga qeverisja qendrore, njësit administrative të krijuar në zbatim të reformës territoriale, pavarësisht se në rregulloren aktuale që përdoret ka përshkrim të detyrave për disa nga drejtorit kryesores si: Drejtoria e të Ardhurave Lokale, Drejtoria Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik etj

➤ **Politikat menaxheriale dhe stili i Punës**

Punësimi në Bashkinë e Kuçovë bëhet në zbatim të Ligjit nr.139/2015 òPër Vetëqeverisjen Vendore, Ligjit nr.152/2013 òPër nëpunësin civil, i ndryshuar dhe Ligjit nr.7961 /1995 òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, VKM nr.243/2015 i ndryshuar me VKM nr.746/2018 Kreu I pika 1,2. Kjo procedurë rregullohet nga vet Strukturat e Bashkisë së Kuçovë:- Drejtoria e Burimeve Njerëzore [DBNJ] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr.152/2013 òPër nëpunësin civil, i ndryshuar dhe VKM nr.243/2015 i ndryshuar Kreu II;

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr.243/2015 i ndryshuar ;

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e,ë,f,g të Ligjit nr.139/2015 òPer Vetëqeverisjen Vendore.



Skema e procedurës së punësimit

Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Kuçovë hartojnë në fillim të çdo viti Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil konform Ligjit nr.152/2015 òPër nëpunësin civil neni 18, VKM nr. 108/2014 òPër planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, VKB òMbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre si dhe Vendimeve të Kryetarit òPër miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Kuçovë për çdo vit ushtrimor.

Planet vjetore janë miratuar me vendimet e sipërcituara dhe janë hartuar mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësisë përbërëse në strukturë. Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë së Kuçovë bëhet në faqen zyrtare të saj, konform VKM nr.243/2015 òPër pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutiveò i ndryshuar Kreu II pika 6.

Konstatohet se përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët nuk jenë të përshkruara në rregulloren e brendshme të Bashkisë. DBNJ nga ana e saj pasi njihet me planin vjetor, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, duke zbatuar përcaktimet ligjore në fuqi, Ligjin nr.152/2015 òPër nëpunësin civilò, VKM nr.108/2014 òPër plani vjetor të pranimit në shërbimin civilò, VKM nr.243/2015 òPër pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutiveò i ndryshuar.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Kuçovë është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 88 datë 16.12.2020 òMbi kategorizimin e nivelit të pagave të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar për punonjësit e bashkisë dhe të njësisve shpenzuese në varësi të Bashkisë Kuçovëòpër vitin 2021 ò,

Nga 77 vende pune me statusin e nëpunësit civil, nga të cilat;:

- 1 (një) pozicion i kategorisë së lartë,
- 8 (tetë)pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
- 13 (trembëdhjetë)pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
- 51 (pesëdhjetë e një) pozicione të kategorive ekzekutive.

Nga 5 vende pune të lira të paplotësuara me statusin e nëpunësit civil, si vijon;

- 0 (zero) pozicion i kategorisë së lartë
- 0 zero) pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
- 2 (dy) pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
- 3 (tre) pozicione të kategorive ekzistuese

Nga auditimi rezulton se vendet vakante në Bashkinë e Kuçovë janë krijuar jo vetëm si rezultat i ristrukturimeve, por edhe si rezultat i funksionimit të kontroleve të brendshme. Një pasqyrim më i detajuar i numrit dhe arsyes e krijimit të vendeve vakante, si vijon;

Nr	Arsyeja e lirimit të vendeve	2019	2020	2021
1	KMCAP	0	1	0
2	Pension	6	11	4
3	Largim me Deshire	20	10	12
4	Shkurtime	2	7	5
5	Kontrate	4	4	1
6	Largim per mosparaqitje ne pune	1	0	0
7	Nderruar jete	0	1	0
8	Mase disiplinore	3	3	0
9	Ngritje ne detyre	0	0	0
10	Lirim pa motivacion (per funksionet me karakter politik)	0	0	0
TOTALI		35	30	17

Burimi i të dhënave: Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore

Konstatohet se numri i personelit në Bashkinë e Kuçovë referuar strukturave organizative, ka ardhur në rritje, por i paplotësuar sipas planit ndonëse edhe numri faktik i tyre ka ardhur në rritje. Në rregulloren e Bashkisë së Kuçovë përshkrimet e punës së çdo pozicioni në strukturën organizative, nuk shoqërohen me përcaktimin e kriterëve të përgjithshme dhe atyre specifike të nevojshme/të domosdoshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013 òPër nëpunësin civilò i ndryshuar.

Konstatim se në strukturën e Bashkisë së Kuçovë nuk janë planifikuar pozicione me status őkselehtë në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017; si dhe pozicione me status të őkGrup i veçantë ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) nënkategori të ndryshme si: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2013 őkPër Nëpunësin Civil ők ndryshuar neni 5; Ligjin nr.93/2014 őkPër Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuar ők neni 1/a; neni 2 pika a/b; neni 4 pika a/ b/ ők; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 ők Për Nxitjen e Punësimit ők neni 3 pika 4 őkGrupe të veçanta ők (17 kategori sociale); neni 20 pika 1/a e 1/b; pika 2; pika 3.

➤ **Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë e Kuçovë.**

Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve (të detyrueshëm dhe fakultativ) ofruar nga ASPA nëpërmjet Platformës ZOOM, për njohuritë e tyre në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për Procedurat e Prokurimit Publik, Auditit i Brendshëm etj. Por nga Bashkia e Kuçovë nuk rezulton të jenë hartuar Plane vjetore trajnimesh për punonjësit e saj, por përzgjedhja e personelit për trajnim është realizuar nga Drejtoria juridike dhe Menaxhimit të burimeve njerëzore ose nga vet punonjësit. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësive kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: őkCaktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për őkdo pozicion pune; őkVerifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës; őkMarrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; őkFutjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. őkKryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për őkdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; őkZhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

Konstatohet se Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Kuçovë nuk janë hartuar plane / programe vjetore për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve, të cilat ndihmojnë në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për të kryer me efikasitet ato, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 őkPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ők dhe őkManualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ők.

2- Menaxhimi i riskut(Në zbatim të kërkesave të nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010). Nga Bashkia Kuçovë është hartuar dhe miratuar Regjistrat e Riskut, ku identifikohen risqet që vijnë nga burime të brendshme dhe risqe që vijnë nga burime të jashtme:

Regjistri i Riskut për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri 31.12.2021 është miratuar me shkresën nr. 1278 prot datë 09.04.2021 konform Ligjit 10296 dt.08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 si dhe Udhëzimit nr.16 dt.20.07.2016 edhe pse nga Bashkia Kuçovë nuk është formuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për vitin 2021, në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit Në zbatim të ligjit nr. 10269 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Me shkresën nr. 2880 prot datë 01.09.2021 janë miratuar gjurmët e auditimit në pajtueshmëri me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standart të zbatimit të buxhetit” pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19 "Gjurma e auditimit"

përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve” dhe neni 16 pika 2.

- Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”, si dhe ligjit nr. 90 datë 27.09.2012 “Për organizimin e administratës shtetërore” si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës Nënpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial).

-Konstatohet se urdhër shpenzimet nënshkruhen nga nënpunësi Autorizues dhe Nënpunësi Zbatuar si dhe nuk është deleguar e drejta e nënshkrimit të urdhër shpenzimeve për kryerje e transaksioneve, në referencë të nenit 21, pika 1,2 dhe 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò.

Nga Kryetari i Bashkisë, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues është punuar për te përmbushur qëllimet Bashkisë, siç janë parashtruar në raportin për menaxhimin financiar dhe Kontrollin, në pyetësorin e plotësuar òPër Menaxhimin financiar dhe kontrollinò, òDeklaratën e funksionimit të kontrollit brendshëm financiar publikeò.

Bashkëpunimin e auditimit e Brendshëm, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, nëpërmjet veprimtarive efektive, eficientë dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

3-Veprimtaritë e kontrollit(Në zbatim të kërkesave të nenin 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion lidhur me takimet e detyrueshme vjetore të GMS, që referuar Ligjit nr.10296/2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò dhe òManualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollinò citohet se òGrupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”

Konstatohet se Bashkia Kuçovë nuk ka miratuar një plan pune vjetor të GMS lidhur me aktivitetet dhe çështjet që do të analizohen, si dhe grafikun e takimeve që do të zhvillohen nga ana e këtij grupi si dhe referuar procesverbaleve vendimeve të takimeve nuk ka të dokumentuar takimet e GMS nuk ka asnjë dokument ku të vërtetoje mbi takimet e GMS për vitin 2021 në kundërshtim të Ligjit nr.10296/2010 òPër Menaxhimin financiar dhe Kontrollinò dhe òManualit të menaxhimit financiar dhe Kontrollinò

Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

Nga auditimi rezulton se në lidhje me *identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut*: Nuk është hartuar asnjë strategji për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *oPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*, ku citohet se; *oTitullari i njësive publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut*.

- Nga institucioni **nuk ka një Plan të Kontrollit të Brendshëm** (sipas Aneksit nr. 11 të Manualit), i cili është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Mungesa e planeve të kontrollit kanë ndikuar dhe në mos monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përbushjes së tyre.

4- Informacioni dhe komunikimi(Në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Inforimimin dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazur edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm.

Përveç kësaj mënyre, informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun vecanërisht lidhur me vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 *oPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*.

5-Monitorimi(Në zbatim të kërkesave të nenin 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse si për marjen në dorëzim të punimeve të kontraktuara, në rastet e indentifikimit të detyrimeve për tatim taksat lokale etj. Një formë e monitorimit, është deklarata e vetëvlerësimit të sisteme të kontrollit të brendshëm.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. *Z. K.L me detyre Përgjegjes i Sektorit të Burimeve Njerezore*

1. *Znj. H.Sh me detyre Drejtor në Drejtorin e Finances dhe e Buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues.*

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *oPër menaxhimin financiar dhe kontrollin* neni 20, 21.

Shkaku:

Neglizhencë e drejtorive/sectorëve për hartimin e rregulloreve, përditësimin e regjistrit të riskut si dhe hartimin e strategjisë së riskut

Ndikimi/Efekti:

Mungon ndarja e qartë e detyrave sipas drejtorive/sectorëve, mos identifikim i shkallës së riskut, mos trajnim efektiv për rritjet profesionale të stafit.

Rëndësia: *E mesme*

Rekomandimi:

- Kryetari i Bashkisë Kuçovë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit si dhe miratimin e gjurmëve të auditimit.
- Drejtoria e Burimeve Njerezore të mari masa për përditësimin e rregulloreve duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, të hartojë programe të

trajtimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

(Për problemet e mësipërme është mbajtur akt-konstatimin nr. 3, datë 22.04.2022)

➤ **Organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm**

Titulli i gjetjes: KLSH ka konstatuar së sektori i Auditit të Brendshëm funksionon me një auditues dhe jo me tre auditues sipas përcaktimeve të VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik” si dhe mos auditimi i sektorëve me risk të lartë.

Situata:

Struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 është miratua me Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 64 datë 11/12/2020 òPër miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Kuçovë, Institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative dhe Funksionet e deleguara për vitin 2021ò. Auditimi i Brendshëm i Bashkisë Kuçovë ka qënë i organizuar me më 3 (tre) punonjës 1 (një) përgjegjës auditimi dhe 2 (dy) specialist auditimi duke u bazuar në Ligjin nr.114/2015 datë 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò neni 10 në VKM nr.83 datë 03.02.2016 òPër miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik ò pika 3, Nga auditimi u rezulton se struktura e Auditit të Brendshëm për periudhën objekt auditimi (2021) ka pasur në organikën e vetë 3 auditues sipas VKM se sipër cituar, nga të cilët 1 përgjegjës respektivisht z. L.Z dhe 2 auditues, znj. E.F dhe znj. J.S në pozicionin e specialistes, të pa certifikuar. Rezulton se gjatë vitit 2021 janë larguar dy punonjës, konkretisht përgjegjësi i auditimit si dhe një auditues situar e cila ka vazhduar përgjat vitit 2021 për rrjedhoj organizimi dhe funksionimi i Sektorit të Auditit të Brendshëm nuk është në nivelin e duhur në mbështetje të menaxhimit të lartë për zbatimin e objektivave, në Bashkinë Kuçovë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim të ligjit nr. 114/2015 ò Për auditimin e brendshëm në sektorin publikò, neni 10, germa òcò e VKM nr.83 datë 03.02.2016 òPër miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik si dhe neni 64, germa òaò të Ligjit nr. 139/2015 òPër Vetëqeverisjen Vendoreò. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur Struktura e sektorit të Auditit të Brendshëm, si vijon;

Nr	Nga data e krijimit deri me 31.12.2021	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
Për vitin 2020							
1	L.Z	Përgjegjës i Sektorit të A.B	Ekonomist	25	2	I pa certifikuar	
2	J.S	Audituese	Ekonomist	3	1	I pa certifikuar	
Për vitin 2021							
1	L.Z	Përgjegjës i Sektorit të A.B	Ekonomist	26	3	I pa certifikuar	Larguar në shtator 2021
2	J.S	Audituese	Ekonomist	4	2	I pa certifikuar	Larguar në mars 2021
3...	E.F	audituese	Jurist	5	1	I pacertifikuar	

II/a.2.-Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditit të Brendshëm:

Nga Sektori i Auditit të Brendshëm janë hartuar dhe miratuar planet e auditimit në zbatim të ligjit nr. 114/2015 òPër Auditimin e brendshëm ne sektorin Publikeò, Planet strategjike dhe

vjetore sipas formateve të dërguar në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave) dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Nga auditimi rezultoi se : Për vitin 2021 Sektori i AB ka planifikuar 12 (dymbëdhjetë) auditime, nga të cilat: janë nisur 2 auditime dhe nuk kanë përfunduar në zbatim të planit konfirmuar me shkresën nr, 3354/1 date 19.10.2020, janë percjelle prane Drejtorise së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave :

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditim e të planifikuara	Auditime te realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Perputh	Financ	Kombi	Performace	Tjera
3	Viti 2021	12	0					

Burimi i krijimit të të dhënave sektori i AB bashkia Kuçovë

Për vitin 2021 çdo mision auditimi, nga audituesit janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar, nga Kryetari, në bazë të planit vjetor si vijon;

- Programi i angazhimit të auditimit të brendshëm në Drejtorinë Juridike me nr.2353 datë 06.07.2021
- Programi i angazhimit të auditimit të brendshëm në Drejtorinë e Zhvillimit Rural me nr. 2354 datë 06.07.2021

Në dosjet e auditimit nuk është e dokumentuar e gjithë puna e kryer nga audituesit, që nga fillimi i misionit deri në përfundim të tij (gjurmët e auditimit).

Konstatohet se njësisia e auditimit raporton drejtpërdrejt tek Kryetari i Bashkisë, tek i cili aprovet plani strategjik, plani vjetor i punës, si dhe raportimi vjetor e periodik mbi veprimtarinë audituese dhe mbi misionet e realizuara, bazuar në kërkesat e nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ò Për auditimin e brendshëm në sektorin publikò.

Sa më sipër vlersojmë se sektori i auditimit të brendshëm nuk e ka ushtruar funksionin e vetë sipas përcaktimeve e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me urdhërin e ministrit të financave nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me rrisqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimit dhe grupin e punës.

III.a 3-Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve u konstatua se:

- Nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, òManuali i Auditimit të Brendshëm (MAB).
- Sektori i A.B në zbatim të planit vjetor nuk ka përfshirë në grup pune specialist të sektorve të ndryshëm, për kryerjen e auditimit sipas programeve të miratuara nga Titullari i Bashkisë. Nuk kanë pararqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit, në përputhje me ligjin 114/2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

II/a.4-Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna.

Sigurimi i cilësisë nuk është pjesë e procesit që bën të mundur zbatimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 òPër Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò me emërtesën òNjësisia e Auditimit të Brendshëmò.

Për periudhën 2021 nga sektori i Auditimit të Brendshëm nuk janë realizuar auditime si rjedhojë nuk janë rekomanduar masa.

-Theksojmë se mungesa e personelit, mungesa e trinineve të stafit të Bashkisë si dhe lëvizja e vazhdueshme e punonjësve nga pozicioni i punës përbën një pengesë në mirëfunksionimin e të gjithë strukturës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

- Nuk janë hartuar Kartën e Auditimit nga Përgjegjësi i njësisë së Auditit të Brendshëm
- Raportimi vjetor për vitin 2021 nuk është përgatitur dhe dërguar në DHAB.
- Specialistët e NJAB në Bashkinë Kuçovë janë emëruar duke qenë të pa pajisur me certifikatën e audituesit.
- Në Bashkinë Kuçovë për periudhën 2021 nuk janë çelur as manualisht as elektronikisht dosjet e përhershme të auditimit.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. L.Z me detyrë ish/Përgjegjës i Njësisë së Auditimit.
2. Znj. J.S me detyrë Specialiste në sektorin e Auditit të Brendshëm
3. Znj. E.F me detyrë Specialiste në sektorin e Auditit të Brendshëm

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligji nr. 114/2015 ò Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, neni 10, germa òcò e VKM nr.83 datë 03.02.2016 òPër Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik si dhe neni 64, germa òaò të Ligjit nr. 139/2015 òPër Vetëqeverisjen Vendoreò. Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me urdhërin e ministrit të financave nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1),

Shkaku:

Mungesë e kapaciteteve për kryerjen e gjitha angazhimeve, neglizhenca e drejtuesit për plotësimin e Strukturës Organizative të Auditit të Brendshëm.

Ndikimi/Efekti:

Nuk jep garanci në mbështetje të menaxhimit të lartë për zbatimin e objektivave, në Bashkinë Kuçovë.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi:

- Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të marrë masa për plotësimin e organikës së Auditimit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin.
- Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.
- Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Kuçovë.

2.1. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2021;

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen

detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

1.1. Programimi i PBA 2021-2022 dhe programimi i buxhetit vjetor 2021:

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2020	Faza e I PBA 2021	Faza e II PBA 2021	Projekt Buxhet 2021
600	Paga	194,363,398	206,339,098	208,630,181	210,826,252
601	Sigurime Shoqërore	32,978,655	34,729,408	35,153,716	35,690,785
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	118,404,481	151,953,936	136,408,366	139,127,827
604	Transferta Korente të brendshme	1,901,048	2,321,785	2,321,785	2,207,460
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	235,669,298	11,868,000	11,128,000	11,238,000
609			9,550,000	9,550,000	19,390,580
I	Shpenzime Korrente	583,316,880	416,762,227	403,192,048	418,480,904
230	Kapitale të Patrupëzuara				
231	Kapitale të Trupëzuara	139,254,756	56,616,596	87,041,216	204,119,611
	Shp. Kapitale me financim te brendshem				
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				
II	Shpenzime Kapitale	139,254,756	56,616,596	87,041,216	204,119,611
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				
	I+II +III Totali I Shpenzimeve	722,571,636	473,378,822	490,233,263	622,600,515

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiakme vendimet:

PBA 2021-2023 miratuar respektivisht me VKB nr.36 , datë 22.04.2020, VKB nr.62, datë 24.08.2020, me VKB nr.01 , datë 05.01.2021,

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2018-2021

Emërtimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Të ardhurat faktike	829,412,432	721,665,671	770,048,224	861,064,614
Shpenzimet faktike	783,192,183	689,082,787	722,571,636	804,688,870
Të ardhurat faktike nga burimet e veta	129,231,392	134,510,822	115,746,620	204,966,236

Me vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr.88 datë 16.12.2020, është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë 384, institucioneve në varësi, njërive administrative dhe funksionet e deleguara për vitin 2021. Me vendimin nr. 88 datë 16.12.2020, është miratuar niveli i pagave të Bashkisë si dhe numri i punonjësve me kontratë të përkohshme.

Për vitin 2021, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 01 datë 05.01.2021, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut me shkresën nr.16/1 prot., dt. 20.01.2021

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2021 kanë vlerën **227,558,000** lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 165,194,000 lekë, transferta specifike ka vlerën 117,968,534 lekë, e ardhur e trashëguar 15,551,979 lekë dhe transfertë e pakushtëzuar 96,328, 002 lekë.

Konstatohet se të ardhurat e planifikuara nga burimet e veta për vitin 2021 në vlerën 227,558,000 lekë nuk ndjekin trendin e realizimit të tyre në vitet paraardhëse, të cilat për periudhën 2018-2020 kanë një realizim mesatar prej 126,496,278 lekë. Ka diferenca të dukshme prej 100 milion lekë midis të ardhurave të realizuara në tre vitet e fundit me

planin e vitit 2021, e cila tregon për një planifikim të pa studiuar mire dhe të pa mbështetur në mundësitë reale të arkëtimit.

Në total në buxhetin fillestar të ardhurat kanë vlerën **622,600,515** lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën **622,600,515** lekë.

Gjatë vitit 2021, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në Janar të vitit 2021). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr.08 , datë 08.02.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Kuçovë për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2021, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 31,630,882 lekë.

- Me VKB nr.09, datë 08.02.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Kuçovë për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2021, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 355,640 lekë.

-Me Vendim nr.13, datë 10.06.2021 është vendosur për pakësimin e planit të shpenzimeve operative të Bashkisë në vlerën 525,150 lekë dhe shtesë në planin e pagave 450,000 lekë e sigurimeve shoqërore 75,150 lekë.

- Me VKB nr.21, datë 24.03.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Kuçovë për a. pakësimin e fondit rezervë dhe shtesë në planin e shpenzimeve operative për shpronësime në vlerën 1,831,956 lekë,

b. Pakësimi plani për shpenzimet operative dhe shtesë plani për investime ne Ndërmarrjen Komunale në vlerën 1,287,600 lekë.

- Me VKB nr.35, datë 19.05.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Kuçovë për a. pakësimin e fondit të emergjencave civile dhe shtesë në planin transferta tek individë në vlerën 106,354 lekë,

b. Pakësimi i fondit rezervë dhe shtesë në planin e shpenzimeve operative për shpronësime në vlerën 600, 000 lekë.

c.pakësimi i fondit rezervë në vlerën 2,967,000 lekë, pakësim në zërn shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 1,400,000 lekë dhe shtesë në zërn investime për bashkëfinancimin e projektit ÷ Përmirësimi i banesave egzistuese per komunitete të varfra e të pafavorizuara në vlerën 4,367,000 lekë.

- Me VKB nr.42, datë 25.06.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Kuçovë për a. miratimin e shtesës në planin e të ardhurave në vlerë 788,000 lekë dhe shtesë në planin e pagave 675,000 lekë dhe planin sigurimeve shoqërore 113,000 lekë.

- Me VKB nr.48, datë 25.06.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Kuçovë për a. pakësimin e fondit të emergjencave dhe shtesë në planin transferta tek individë në vlerë 3,708,646 lekë.

-Me VKB nr.65, datë 29.09.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Kuçovë për pakësimin e panit të shpenzimeve operative të Bashkisë dhe shtesë në planin e shpenzimeve operative të Qendrës Ekonomike të Arsimit në zërn shpenzime transporti në vlerën 300,000 lekë.

Lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2021 nga të ardhurat e veta dhe granti pasqyrohen në aneksin nr. 2, pika 2.1, bashkangjitur projektraportit të auditimit.

Pasqyra përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2021 sipas VKB përkatëse, pasqyrohet në aneksin nr. 2/1, pika 2.1, bashkangjitur projektraportit të auditimit.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në total në buxhetin fillestar të ardhurat kanë vlerën 622,600,515 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 622,600,515 lekë. Në vijim gjatë vitit, pas miratimit të buxhetit

filleshtar, janë çelur fonde ë tjera nga transfertat, fondet e trashëguara, grantet dhe buxheti i bashkisë së bashku me këto fonde ka vlerën 682,065,997 lekë.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2021-2023 me planin buxhetor 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundimtar 2021	Sipas PBA 2021-2023	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant ipakkush e spec)	258,117,810	246,517,037	11,600,773
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	183,732,041	171,963,867	11,768,174
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant I pakushtez)	128,178,515	111,641,609	16,536,609
4	Investime nga FZSH	92,478,002	92,478,002	0
	Total I planit filleshtar	662,506,368	622,600,515	39,905,853
	Shtesat nga Pushteti Qendror	19,559,629		
5	Investime grant i kushtëzuar	16,060,629		
6	Shpenzime për pagat (600+601)	2,355,000		
7	Shpenzime (602.604.609)	1,144,000		
	<i>Grant i kushtëzuar (230-231)</i>			
	Gjithsej	682,065,997		

Burimi: Bashkia Kucove, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Plani buxhetor vjetor 2021 është më i lartë se plani vjetor 2021 në PBA, në shumën 39,905,853 lekë për arsye se në planin buxhetor vjetor (pas hartimit të PBA), janë shtuar fondet e mëposhtme, të cilat për shkak të kohës së mëvonshme të alokimit (në një rast të riplanifikimit), nuk mund të jenë pjesë e PBA:

- E ardhura e trashëguar në vlerën 31,986,522 lekë.
- Shtesë në transfertën specifike në vlerën 5,093,834 lekë.
- Shtesë në transfertën e pakushtëzuar 2,037,497 lekë.
- Shtesë në planin e të ardhurave të veta në vlerën 788,000 lekë.

Në vitin 2021 është trashëguar si detyrim i prapambetur vlera prej 147,448,183 lekë, nga e cila është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2021 vlera prej 108,935,763 lekë, ose 74%, sipas të dhënave në vijim:

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapambetur	Deyrimi i prapambetur progresiv deri 31.12. 2020	Planifikimi për likuidim në planin e buxhetit 2021 i vlerës së detyrimit të prapambetur
4864100	Vendime gjyqesore	473,314	473,314
4864200	Sherbime	14,435,151	14,435,151
4864300	Investime	126,363,273	91,857,673
4864904	Transferta tek subjektet	1,169,625	1,169,625
	Totali	142,441,363	107,935,763
	Detyrime te prapambetura nga FZHR (Ministrite e linjë	5,006,820	1,000,000
4864903	Transferta tek individet	4,920,000	1,000,000
4864300	Investime	86,820	0
	Totali	5,006,820	1,000,000
	Detyrime ne total	147,448,183	108,935,763

Burimi: Bashkia Kucove, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe

fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me vendim të KB.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Kuçovë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Tabela e ndryshimeve në buxhet paraqitet në aneksin nr.2/, bashkangjitur projektraportit të auditimit.

2.3. Mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës Covid-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2021

Duke ju referuar të gjitha fondeve, pavarësisht burimit të financimit, përfshirë edhe ndihmën ekonomike, analiza e planit dhe faktit të buxhetit është si vijon:

Planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 682,065,997 lekë, realizimi 600,989,320 lekë, ose në masën 88 %.

Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 260,332,810 lekë dhe është realizuar në vlerën 245,947,735 lekë, ose në masën 94%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 151,616,434 lekë dhe është realizuar në vlerën 134,428,687 lekë, ose në masën 89 %.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 236,717,146 lekë dhe është realizuar në vlerën 208,053,403 lekë, ose në masën 88 %.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 kanë diferenca me vlerën e planifikuar.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është planifikuar në vlerën 236,717,146 lekë, realizuar 208,053,403 lekë, ose në masën 88 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kuçovë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion për rishikimin e tij në lidhje me angazhimet e reja buxhetore, për të përshtatur trendin e shpenzimeve me trendin e të ardhurave faktike, si dhe për të mos krijuar detyrime të reja të prapambetura.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore, ku thuhet:

òKryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenin 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore.

Niveli i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta

Për vitin 2021. Për këtë periudhë (duke zbritur nga shpenzimet totale vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK prej 10,441,832 lekë), shpenzimet faktike totale janë në vlerën 590,547,488 lekë kundrejt 665,872,997 lekë të planifikuara.

Bazuar në këtë vlerë, realizimi i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta të njësisë vendore ka vlerën 197,688,259 lekë lekë, ose në masën 33 % të shpenzimeve totale të planifikuara. Të dhënat e mësipërme tregojnë për nivele të ulëta të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta.

Bashkia Kuçovë nuk ka miratuar fonde të posaçme për situatën e krijuar nga Covid 19 dhe vlera e shpenzuar nga fondi i emergjencave në vitin 2021 për situatën Covid 19, është në vlerën 0 lekë.

Plani dhe fakti i buxhetit të Bashkisë pa njësitë vartëse

Emertimi I shpenzimeve	Art	Plani	Fakti
Paga	600	97,348,040	88,251,304
Sigurime shoqerore	601	15,503,488	13,875,313
Shpenzime operative	602	80,903,457	67,694,710
Transferime korrente tek nivele te tjera te Qeverise	604	7,029,983	2,117,658
Transferata ne buxhete familjare	606	6,425,000	2,848,472
Fondi rezerve	609	10,176,624	-
Investime	231	234,789,546	206,296,203
Shuma nga plani i bashkise		452,176,138	381,083,660
Transferata buxhetore paaftësi e ndihme ekonomike	606	212,279,700	203,699,550

Shuma totale	Bashkia	664,455,838	584,783,210
--------------	---------	-------------	-------------

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit

Janë përgatitur çdo 4 muaj dhe janë dërguar në Këshillin Bashkiak dhe në Ministrinë e Financave si dhe janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit.

Raportet e monitorimit janë dërguar në MFE, sipas shkresave të vijimit:

- Me shkresë nr. 1739/1 prot., datë 28.05.2021 është dërguar raporti i monitorimit për periudhën Janar - Prill 2021.
- Me shkresë nr.3171 prot., datë 24.09.2021 është dërguar raporti i monitorimit për periudhën Janar óGusht 2021.
- Me shkresë nr. 513 prot., datë 15.02.2022 është dërguar raporti i monitorimit për periudhën Janar- Dhjetor 2021.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2021, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në aneksin nr.2/3, bashkangjitur projektraportit të auditimit.

Titulli i gjetjes: Diferenca midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar, për zërat të cilët mbulohen nga të ardhurat e veta.

Situata: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 kanë diferenca me vlerën e planifikuar, pasi planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 682,065,997 lekë, ndërsa realizimi vlerën 600,989,320lekë, ose në masën 88%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kuçovë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Konstatohet se të ardhurat e planifikuara nga burimet e veta për vitin 2021 në vlerën 227,558,000 lekë nuk ndjekin trendin e realizimit të tyre në vitet paraardhëse, të cilat për periudhën 2018-2020 kanë një realizim mesatar prej 126,496,278 lekë. Ka diferenca të dukshme prej 100 milion lekë midis të ardhurave të realizuara në tre vitet e fundit me planin e vitit 2021, e cila tregon për një planifikim të pa studiuar mire dhe të pa mbështetur në mundësitë reale të arkëtimit.

Gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion për rishikimin e tij në lidhje me angazhimet e reja buxhetore, për të përshtatur trendin e shpenzimeve me trendin e të ardhurave faktike, si dhe për të mos krijuar detyrime të reja të prapambetura.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore.

Efekti: Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të planifikimit jo të mbështetur në të ardhurat reale, bënë që prishmëritë sidomos në investime të mos përputhen me planifikimin, plotësimin e nevojave reale të planifikuara dhe ulje të performancës të njësisë vendore.

Shkaku: Planifikim i pa studiuar mire i buxhetit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtorisë e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e

këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e msipërme ngarkohen me përgjegjësi kryetari i bashkisë z. K.H, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj.H.Sh, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

1.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)

Titulli: Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura dhe mos raportimi i plotë i tyre.

Situata: Bashkia Kuçovë nuk ka marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 151,289,512 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Nga kjo vlerë gjatë vitit 2021 është likuiduar vlera 106,747,689 lekë, ose 71% e detyrimit. Por gjatë vitit 2021 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 61,443,991 lekë, duke e çuar vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021 në 105,985,814 lekë, ose në masën 70% të detyrimeve në fillim të vitit buxhetor.

Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021, krahasuar me këtë vlerë në fillim të këtij viti ushtrimor është ulur në masën prej 30%.

Detyrimet e prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion.

Vlera e raportuar nga Bashkia Kuçovë në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2021 është 11,923,434 lekë, ndërsa vlera e detyrimeve të prapambetura të rakorduar me degën e thesarit dhe pasqyruar në pasqyrat financiare të bashkisë pa njësitë vartëse është 122,386,434 lekë. Duke përfshirë edhe detyrimet e njëjësive vartëse, vlera totale e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kuçovë është 124,173,474 lekë, nga e cila vlera prej 1,787,040 lekë i përket njëjësive vartëse, ndërsa vlera prej 122,386,434 lekë, bashkisë pa njësitë vartëse.

Si përfundim vlera e raportuar nga Bashkia Kuçovë në MFE për detyrimet e prapambetura prej 11,923,434 lekë, nuk pasqyron vlerën e saktë të këtyre detyrimeve dhe nuk rakordon me vlerën reale të rakorduar me degën e thesarit e cila është 124,173,474 lekë.

Diferenca midis vlerës së detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE me vlerën e rakorduar me degën e thesarit është 112,250,040 lekë më pak në MFE, e pa raportuar në këtë të fundit, nga të cilat:

- 3,920,000 lekë janë detyrime për shpërblim lindje që financohen nga Ministria e Brendshme.
- 14,267,661 lekë janë detyrime për investime që financohen nga grand i kushtëzuar, për kontrata shumëvjeçare.
- 93,956,779 lekë janë detyrime për investime që financohen nga fondet e veta të Bashkisë, për kontrata shumëvjeçare.
- 105,600 lekë janë detyrime për investime që financohet nga fondet e veta të Bashkisë, nuk është likuiduar për mungesë dokumentacioni, detyrim i trashëguar nga ish komunat.

Detyrimet e prapambetura të raportuar në MFE për vitin 2021

Artikulli	Bashkia	Ndërmarrja Komunale	Qendra Ek. e Arsimit	Totali ne leke
Shpenzime operative	140,171	643,400	1,143,640	1,927,211
Investime	9,996,223			
Totali	10,136,394	643,400	1,143,640	11,923,434

Detyrimet e prapambetura sipas rakordimit me thesarin për vitin 2021, së bashku me njësitë vartëse:

Detyrimet e prapambetura sipas rakordimit me thesarin për vitin 2021 së bashku me njësitë vartëse				
	Bashkia	Ndërmarrja Komunale	Qendra Ek. E Arsimit	Totali ne leke
Shpenzime operative	140,171	643,400	1,143,640	1,927,211
Investime	118,326,263			118,326,263
Shpenzime për shpërblim lindje	3,920,000			3,920,000
Shuma	122,386,434	643,400	1,143,640	124,173,474

Vlera totale e investimeve përbëhet:

- Vlera 9,996,223 leke detyrime që i përkasin vitit 2021;
- Vlera 14,267,661 lekë detyrime që financohen nga FSHZH;
- Vlera 94,062,379leke është detyrim i lindur nga lidhja e kontratave shumëvjeçare të investimeve.

Bashkia Kuçovë së bashku me njësitë vartëse në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën **156,296,332** lekë, e cila ka si burim financimi vlerën 151,289,512 lekë nga të ardhurat e veta, ose 97% të totalit, ndërsa vlera prej 5,006,820 lekë është detyrim nga FZHR.

Nga vlera e detyrimit 156,296,332 lekë në planin e buxhetit vjetor 2021 është planifikuar për likuidim vlera 117,783,912 lekë, nga e cila është likuiduar në fakt vlera 107,747,689 lekë, ose 91 % e vlerës së planifikuar, diferenca prej 10,036,223 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2021. Megjithëse janë bërë likuidime për llogari të detyrimeve të akumuluar të prapambetura, konstatohet se gjatë vitit 2021 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 75,624,832 lekë, nga e cila vlera 61,443,991 lekë, ose 81% është e krijuar nga të ardhurat e veta, ndërsa vlera 14,180,841 lekë, ose 19 % e totalit nga granti.

Si rezultat i krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura gjatë vitit 2021 dhe i detyrimeve të trashëguara, vlera e tyre më 31.12.2021 është 124,173,474 lekë, nga e cila vlera 105,985,814 lekë ose 85% e është krijuar nga të ardhurat e veta, ndërsa vlera 18,187,661 lek ose 15% e totalit nga granti. Ulja e vlerës së detyrimeve të prapambetura në fund të vitit buxhetor 2021 krahasuar me vlerën në fillim të vitit buxhetor, është 32,122,858 lekë, ose në masën 21%, e cila tregon se çështja e detyrimeve të prapambetura nuk është vlerësuar si duhet nga Bashkia Kuçovë. Peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime në vlerën 118,326,264 lekë, ose në masën 95% të detyrimeve të prapambetura.

Njësitë shpenzuese në varësi të Bashkisë Kuçovë në datën 01.01.2021 kanë pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 8,848,149 lekë, që ka si burim financimi të ardhurat e veta. Ky detyrim është parashikuar në buxhet dhe është likuiduar gjatë vitit 2021. Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2021 nga njësitë shpenzuese në varësi të Bashkisë janë në vlerën 1,787,040 lekë.

Kriteri: Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të reja të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.02.2014 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, pikat 82-91, UMFE nr.37, datë 06.10.2020 për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme.

Ndikimi/Efekti: Mos likuidimi i plotë i detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit, bënë që një pjesë e buxhetit të vitit pasardhës të vihet në dispozicion të këtyre detyrimeve, duke ulur vlerën e fondeve në dispozicion për investime e shërbime. Likuidimi me ritme të ngadalta të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë nën vëndore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur është shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.

Shkaku: Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Kuçovë dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe he Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për raportimin në MFE për të gjitha detyrimet e prapambetura, pavarësisht burimit të tyre të financimit.

Për mos marrjen e masave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2021 -31.12.2021, ngarkohet me përgjegjësi kryetari i Bashkisë Kuçovë z. K.H, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj.H.Sh, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Në formë të dhënash sintetike detyrimet e prapambetura paraqiten në aneksin nr.2/4, bashkangjitur projektraportit të auditimit, ndërsa lista analitike e detyrimeve të prapambetura paraqitet në aneksin 2/6 bashkangjitur projektraportit të auditimit.

Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe shpronësimet

Për vitin 2021 vlera e paguar nga Bashkia Kuçovë për zbatimin e vendimeve gjyqësore për dëmshpërblim page për punonjësit e larguar nga puna ka vlerën 292,680 lekë për një rast, i cili konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.

Për shpronësimet është shpenzuar vlera 4,293,615 lekë, me burim financimi grant. shpronësimet janë bere për projektin "Ndërtimi i ish -Parkut Kuçovë" sipas VKM nr 660 dt 27.08.2020

3.5 Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSHH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2021 janë lidhur 5 kontrata investimesh me fonde të FZHR, në vlerën e plotë të kontratës 488,041,459 lekë, likujduar 121,176,499 lekë, pa likujduar vlera 360,269,262 lekë, për

shkak se likuidimi është shtrirë në kohë sipas parashikimit në kontratë, kohë e cila është jashtë vitit 2021.

Pasqyra e kontratave për investime të financuara nga FZHR dhe likuidimet sipas periudhave paraqitet në aneksin 2/5 bashkangjitur projektraportit të auditimit.

Për sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.1, datë 22.04.2022.

2.2. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre

➤ Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2021 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 88, datë 16.12.2020, òPër miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kuçovë dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2021ò, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas strukturës është e përbërë nga sektorë dhe në total ka 12 punonjës: ku 1 specialistë për IT, 1 specialist i Shërbimit të tatimpaguesve, 1 specialist për menaxhimin e borxhit , 1 përgjegjës i sektorit të kontrollit dhe i masave shtrënguese, 5 agjentë tatimor dhe 1 Inspektor të ardhurash të tregut të përqëndruar. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur Projektraportit të auditimit.

Titulli gjetjes:*Mangësitë e konstatuara në plotësimin e strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.*

Situata:Struktura e DAV Bashkia Kuçovë ka probleme dhe nuk është në funksion të realizimit e të ardhurave, edhe pse është krijuar Sektori i Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në DAV Bashkia Kuçovë, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor), në vlerën **104,080 mijë lekë**, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 17,493 mijë lekë dhe abonentë familjarë në vlerë 86,587 mijë lekë. Gjithashtu rezulton se në strukturën organizative të DAV Bashkia Kuçovë, janë evidentuar lëvizje të shpeshta të stafit si dhe mangësi në plotësimin e shtruktues organizative me specialit respektivisht; Specialist IT për përdorimin e programit kompjuterik çka sjell mos evidentimin e subjekteve, mos llogaritjen e detyrimeve fiskale për këto mos deklarime si dhe mos arkëtimin e të ardhurave, kjo për mungesë stafi, në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot datë 07.02.2018. Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi nëpunsin Autorizues si dhe Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

-Nga Drejtoria e të Ardhurave Lokale, nuk është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, për të gjitha detyrimet tatimore dhe nuk janë vendosur në dosjen e çdo taksa paguesi, nuk është bërë përditësimi i të dhënave dhe nuk është plotësuar dokumentacioni, ku të regjistroheshin të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, Neni 29 Dosja e detyrimeve tatimore, pika 1, citohet : òAdministrata tatimore krijon dhe përditëson dosjen e detyrimeve tatimore, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit”.

-Nga Drejtoria e të Ardhurave Lokale, nuk është vepruar për të kryer inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi e konkretisht:

-të gjitha praktikat nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit.

-i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë.

-praktikat e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim, me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 òPër arkivatò neni 24, ku përcaktohet: *Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore kanë detyrë : a) të evidencojnë korrespondencën që dërgohet ose merret nga institucioni b) të bëjnë përpunimin arkivor, të ruajnë dhe të shërbejnë dokumentet që administrojnë, c) të dorëzojë dokumentet në arkivat shtetërore, sipas afateve ligjore përkatësisht sipas përshkrimit në nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të këtij ligj, dhe me rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave "Për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" kapitulli II-Rregulla për punën me dokumentet administrative në subjektet shtetërore dhe jo shtetërore, neni 21 dhe neni 27.*

Kriteri:Në përputhje me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar dhe në Kreun XI- òMbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar", nenet 29 pika 1, 88 ó 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 òPër Procedurat Tatimore në RSHò me ndryshime.

Ndikimi/Efekt: Mungesa e stafit dhe mos përshtatja e strukturës më natyrën e menaxhimit të të ardhurave, çojnë në mos realizim të të ardhurave dhe mungesë të tyre në buxheti e Bashkisë Kuçovë.

Shkaku:Mos njohja e kuadrit ligjorë për ,menaxhimit e të ardhurave nga instancat drejtues Bashkia Kuçovë.

Rëndësia: i lartë

Rekomandimi:Kryetari i Bashkisë Kuçovë në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Kuçovë me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave.

- DAV Bashkia Kuçovë të marrë masa për përditësimin e të dhënave me dokumentacionin e nevojshëm, ku të regjistroheshin të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.

Titulli i gjetjes:*Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e disa zërave të të ardhurave për periudhën objekt auditimi.*

Situata:Për vitin 2021, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 74, datë 24.11.2020, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 1550/1 datë 19.12.2019. Në mënyrë të detajuar paraqitet në **aneksin nr. 2 pika 2.6 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.**

Rezulton se për vitin 2021 plani fillestar është në vlerën 209,000 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 204,966 mijë lekë ose 98 %, sipas planit të ndryshuar mos realizim në vlerën 4,034 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit. Konstatohet se:

-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e

mjeteve të përdorura që ka Bashkia Kuçovë. Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë. Drejtoria e të Ardhurave, duke mospatur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Kuçovë (DRTB), Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Kuçovë (ASHKK) dhe Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Kuçovë (DSHTRB).

Taksë e tokës, taksë ndërtese, tarifë pastrimi, ndriçimi dhe gjelbërimi, për abonentët familjarë Bashkia Kuçovë e realizon nëpërmjet agjentit tatimor që në rastin konkret është UK Kuçovë, sipas kushteve të akt-marveshjes nr.07, datë 07.01.2014, në të cilën sanksionohet të përfshijë në faturën e ujit për kategorinë abonentë ÷Familjarë detyrimet për Taksa e tarifa si më sipër. Drejtoria e të ardhurave për familjet që nuk kanë një kontratë me UK Kuçovë nuk ka një baza e të dhënave për familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellësin përditësohet vetëm për rastet kur familjarët paraqiten pranë zyrave të bashkisë për të marrë shërbime të ndryshme. Akt rakordimet me agjentët tatimorë nuk janë mbajtur sipas formatit të përcaktuar me Udhëzim të posaçëm nga Ministria e Financave. Rakordimet janë bërë në formë proces-verbalesh, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nuk ka asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Neni 117 ÷Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave, ku përcaktohet se: ÷Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifatat e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangu.ö, UMF Nr. 26, datë 4.9.2008 ÷Për Taksat Kombëtare, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. K.H me detyrë Kryetar i Bashkisë Kuçovë; z. A.C, me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Lokale; z. S.L me pozicion ish Përgjegjes i sektorit të kontrollit dhe i masave shtrenguese, aktualisht në funksionin e Drejtor të Drejtorisë së të Ardhurave Lokale.

Kriteri:Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, ÷Për vetëqeverisjen vendore, neni 64, ÷Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 ÷Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore i ndryshuar, neni 5, ÷Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore, neni 42, ÷Administrimi i mjeteve monetare, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, ÷Raportimi financiar nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV ÷Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ÷Për Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 ÷Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt:Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkak kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Shkaku:Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa për

një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e një plani të pa realizueshëm në fakt.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

Titulli gjetjes: *Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin mbi aktivitetin e Agjentëve Tatimorë.*

Situata: Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore Kuçovë, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Kuçovë, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Kuçovë dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Kuçovë. Ghithashtu Bashkia Kuçovë, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Në nenin 117² të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, *“Për Procedurat Tatimoreö, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifaveö.*

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjellës-Kanalizime. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi i planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

Konstatojmë se mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Kuçovë, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Kuçovë është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektsh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Kuçovë duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korespondencë me Ministrinë e Financave.
- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithëshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimitö dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendoreö, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimiö, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtareö*

² “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifat e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangur.”

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë paraqitur në **Pasqyrën Pasqyra si vijon:**

Agjenti Tatimor	Lloji I Taksës	2021
Posta shqiptare		92,962
Drejtoria Rajonale e Tatimeve	Tatimi I Thjeshtuar	0
Drejtoria Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor	Taksa e mjeteve të përdorura të transportit	14,592,284
Ujësllës Kanalizime Kuçovë	Tarifat/ gjelbërim, ndriçim, pastrim, arsimit, ndërtesa	20,611,671
Totali		35,296,917

Burimi: *Bashkia Kuçovë*

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. K.H me detyrë Kryetar i Bashkisë Kuçovë; z. A.C, me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Lokale; z. S.L me pozicion ish Përgjegjës i sektorit të kontrollit dhe i masave shtrenguese, aktualisht në funksionin e Drejtor të Drejtorisë së të Ardhurave Lokale.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, neni 7 *ËTë drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit* dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *ËPër sistemin e taksave vendore*, i ndryshuar, neni 15 *ËParapagimi*, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 *ËPër taksat Kombëtare*

Ndikimi/Efekti: Mos njohja e situatës, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Kuçovë

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos zbatimit të kuadrit ligjorë.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Kuçovë nga taksat që mbledhen nga këta agjent. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë sakt mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Kuçovë të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Titulli gjetjes: *KLSH-ja konstaton se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kuçovë, nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi), dhe për të gjithë subjektet.*

Situata: Sipas të dhënave për strukturën organike të Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Kuçovë, konstatohet se nuk ka një të ngritur një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifave vendore).

Referuar të dhënave të paraqitura nga kjo drejtori, detyrimet për taksat e tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare paraqitet si vijon:

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

- *Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve*

Tarifa e pastrimit parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të bashkisë.

Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrimit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.

Nga auditimi u konstatua se bashkia Kuçovë ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësllës Kanalizimeve Kuçovë për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese*

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifave vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, nivelin e tyre,

afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familiar në vlerën **86,587,131 lekë, ndërsa detyrimet e vitit ushtrimorë janë në vlerën 14,137,332 lekë** sipas rakordimit me Drejtorinë e Financës. Vlerë e cilapërbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Kuçovë, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familiar deri në datën 31.12.2021. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore, të ndryshuar.

Në **Pasqyrën vijuese** janë paraqitur të përmbledhur detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifatat vendore të vitit ushtrimor 2021 si vijon:

Nr.	PER ABONETET FAMILJAR	DETYRIME SIPAS VITEVE	
		Viti 2021	
		Nr. Familje	Vlera
1	Taksa e tokës bujqësore	3285	5,507,589
2	Taksa pastrimi, gjelbrimi, ndriçimi	3621	4,255,526
3	Taks ndertese (objekt banimi)	4088	2,757,382
4	Taksa vaditje	1785	878,840
5	Te tjera.....		737,995
B	SHUMA		14,137,332

Burimi: *Bashkia Kuçovë*

➤ **Taksa e tokës:**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2021, u konstatua se kishte rezerva në planifikim, pasi sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit të AMTP, mbi ndarjen e tokës bujqësore për familje dhe boniteti.

Rezulto se Bashkia Kuçovë nuk disponon të dhëna mbi sipërfaqen e AMTP të ndara sipas ligjit 7501 òPër tokën o cka do të thotë se planifikimi i taksës së tokës nuk është real. Kështu sipas të dhënave të pasqyrës sipërfaqja gjithsej e tokës së **ndarë sipas fshatrave dhe familjeve për Njësit Administrative Perondi dhe Kozare** është 4461.7 ha e ndarë sipas kategorive, ndërsa Njësia Administrative Lumas nuk disponon të dhëna. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB. Planifikim i kësaj takse për një vit ushtrimorë është në vlerën **13,056 mijë lekë**, por në fakt nga DAV Bashkia Kuçovë është realizuar në vlerën **6,124 mijë lekë dhe mosrealizim në vlerën 6,932 mijë lekë**. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 3 pika 6 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, nuk janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet se informacionet që kërkohen të dhënat nuk dalin të analizuar për çdo zë tatimor që DAV Bashkia Kuçovë aplikon.

Referuar të dhënave të marra nga DAV Bashkia Kuçovë, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2020	515	65	21	559
		2021	559	75	56	578
2	Biznesi Madh	2020	116	4	2	118
		2021	118	5	1	122
(1+2)	Gjithsej	2020	631	69	23	677
		2021	677	80	57	700

Burimi: Bashkia Kuçovë

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën **17,493,818 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë.**

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

Debitore në vite				Shtesa	Total debitor 1.1.2022
Nr.debit	Subjektet	Debit me 01.01.2021	Arket debit ne 2021		
				Debitor '21	
4	Biznes Vogel	9,513,927	567,627	4,174,341	16,353,411
5	Biznes Madh	1,856,711		1,376,059	
6	Nd&Instit.	22,649,275	21,671,108	162,240	1,140,407
	Shuma	34,019,913	22,238,735	5,712,640	17,493,818

Burimi: Bashkia Kuçovë

Sa me sipër ariet në konkluzionin se nga strukturat tatimore të bashkisë Kuçovë, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pas** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181, *“Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”,* të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.ö

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”,* i ndryshuar neni 9 *“Të drejtat dhe përgjegjësitë”* pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.ö

Neni 35, *ōTē ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*, me ligjin nr. 68/2017 *ōPër financat e vetëqeverisjes vendore* i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 *ōPër sistemin e taksave vendore*, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Në mënyrë të përmbledhur vlera debitorë paraqitet në aneksin nr.4 pika 2.6 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. K.H me detyrë Kryetar i Bashkisë Kuçovë; z. A.C, me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Lokale; z. S.L me pozicion ish Përgjegjes i sektorit të kontrollit dhe i masave shtrenguese, aktualisht në funksionin e Drejtor të Drejtorisë së të Ardhurave Lokale z. H. pozicion Specialist IT në Drejtorin e të Ardhurave Lokale dhe z. E.MV me pozicion Specialist i menaxhimit të borxhit

Kriteri: Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 *ō “Çregjistrimi i subjekteve tatimore”* dhe Kreun XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *ōPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 *-Mospagimi i taksave dhe tatimeve*³.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, ku në fund të vitit 2021 ka një vlerë afërsisht sa plani vjetore i të ardhurave të Bashkisë Kuçovë.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi, si dhe mungesa e një strukturë organizative të përshtatshme.

Rëndësia: i lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kuçovë, bazuar në nenin 70 pika 3 *ōE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *ōPër Procedurat tatimore në R.SHō*, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **104,080 mijë lekë**, duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

- a- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.
- b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).
- c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 *ōMospagimi i taksave dhe tatimeve*.
- d- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Kuçovë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksat e ndikimit në infrastrukturë:**

Titulli gjetjes: *KLSH konstatoj se Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kuçovë në lidhje me legalizimet dhe pagesën e*

³Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithëse mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve në vlerën **6,694,192 lekë**, shumë e cila përben të ardhur të munguar për Bashkinë

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Kuçovë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Kuçovë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Kuçovë.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2021, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 16,589,313 lekë për 621 persona, kanë paguar detyrimet 314 persona me vlerë **9,899,435 lekë** dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2021 gjithsej **307** persona me vlerë **6,694,192 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kuçovë (sipas listës të administruar në CD).

Natyra e debitorëve	Detyrime gjithsej 2016-2021		Arkëtuar deri 31.12.2021		Debitorë me 31.12.2021	
	Pers on	Lekë	Per son	Lekë	Person	Lekë
Taksa infrastrukture (legalizim)	621	16,589,313	314	9,899,435	307	6,694,192

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Kuçovë për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Kuçovë të jetë drejtuar ASHK Dega Kuçovë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 òPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizimò i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave vendore, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1 dhe ngarkohen me përgjegjësi z. F. P. me pozicion Drejtor në Drejtorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik dhe z. A.C. me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Lokale.

Kriteri: Me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 òPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizimò i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave vendore, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1.

Ndikimi/Efekt: Mos arkëtimi i detyrimeve taksës së ndikimit në infrastrukturës nga ndërtimet pa leje, ka çuar në mungesë të ardhurash në vlerën **6,694,192lekë**, për buxhetin e Bashkisë

Shkaku: Mos kryerja e akt-rakordimeve midis Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kuçovë dhe ASHK Rajonale Kuçovë, për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:- Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **6,694,192lekë** ndaj **307** personave si dhe tã kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK

Kuçovë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Titulli gjetjes: *Lejimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me Licencë të bashkisë dhe papaguar tarifën në zbatim të VKM nr. 344, datë 19.04.2017.*

Situata: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nga Bashkia Kuçovë për vitin ushtrimor 2021 ushtrojnë aktivitetin 14 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 5 pika 2.6 bashkëlidhur projektraportit të auditimit. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, rezulton se 4 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjecar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe kanë paguar detyrimet 3 subjekte në vlerë 1,200,000 lekë dhe nuk ka paguar detyrimet 1 subjekt në **vlerën 900,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kuçovë, ndërs 10 subjekte janë pajisur me autorizim 1 vjecar të cilët kanë paguar detyrimet në vlerë 2,000,000 lekë sipas VKB nr. 79 datë 25.11.2020** “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2021” fq 11 pika 7 të miratuar në Bashkinë Kuçovë shprehet se pagesa për dhënien e licencës do të kryhet në mënyrë përpjestimore: 1/5 e tarifës para marrjes së licencës dhe çdo fillim viti pasardhës nga 1/5 deri në realizim të tarifës së plotë, e cila bie në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa òbò, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa òbò dhe pika 9 dhe 15

Kriteri: Në kundërshtim me nenin 35 të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. e VKM nr. 170, datë 25.4.2002 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa òbò, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa òbò dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Mos ndjekja e procedurës për dhënien e Licensës së tregtimit të karburanteve, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Kuçovë me vlerë **900,000 lekë**.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitet pa dokumentacion të rregullt.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së patakuar prej **900,000 lekë** ndajë 1 subjekteve, sipas pasqyrës Aneks nr. 6 pika 2.6 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

(Për problemet e mësipërme është mbajtur akt-konstatimin nr. 5, datë 22.04.2022)

Pika 3. Vlerësimi i raportimit financiar

➤ ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2021 nga njësia shpenzuese òBashkia Kuçovë për hartimin e pasqyrave financiare

dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kuçovë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

➤ ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2021 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

➤ ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program **Excel**
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu; dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrjedaljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njesisë ekonomike.

➤ ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar për vitin vitin 2021.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2021.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat janë regjistruar në momentin e çeljes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar dhe të analizuar përsa i përket aseteve e ish-Komunave. Ndërsa detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, ndërsa mungojnë shënimet që të shprehin paqartësitë e ndodhura .

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria Financës. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2021 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2020.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2021 është **1,306,610,930lekë** dhe për vitin 2020 është **1,166,948,528 lekë**, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari, sipas **Aneksit nr. 1 pika 3** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyrara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor të vitit 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit, si në vijim.

A.Aktivitet.

I. Rubrika, aktivitet afat shkurtra.

1.Nën rubrika, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, më 31.12.2021, paraqitet në vlerën **66,492,663 lekë**, e cila përfaqësojnë vlerën e fondeve që trashëgohen në vitin e ardhshëm. Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar si vijon:

Nr.	Llogaria	2021
1	Llogaria 520 òDisponibilitete në thesarò	66,492,289
2	Llogaria 466 òKreditorë për mjete në ruajtjeò	10,390,253
3	Llogaria 85òRezultati i veprimtarisë së ushtrimitò	56,562,100

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 rezultoi se llogaria 520 òDisponibilitete në Thesar” ka si kundër parti llogarit 466 òKreditorë për mjete në ruajtjeò dhe llogarinë 85 òRezultati i veprimtarisë së ushtrimitò duke i zbritur òNdryshimin e gjendjes së inventaritò.Nga analiza e formatit nr. 2 të pasqyrave financiare rezultoi se llogaria 85 Rezultati i veprimtarisë së ushtrimitò është në vlerën 51,102,036 lekë, e **kuadruar me të dhënat** e Degës së Thesarit në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

2.Nën rubrika, gjendje e inventarit qarkullues, gjendja e llogarisë **31 “Materiale”**, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 2,494,550 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjës të financës dhe drejtorit të financës.

-Gjendja e llogarisë **32 “Inventar i imët”** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 2,935,083 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjës të financës dhe drejtorit të financës.

Titulli i Gjetjes: Mos zbatimi i procedurave ligjore në arkëtimin e detyrimeve të konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit

Situata:

Gjendja e llogarisë **468 “Debitorë të ndryshëmò** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 159,400,036lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontroleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2021. Në mënyrë analitike paraqitet në aneksin nr. 2 pika 3 bashkëlidhur Projektraportit të auditimit.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se Drejtoria e Financës me shkresën përcjellëse nr. 3549, datë 17.10.2018 i është drejtuar Drejtorisë Juridike për ndjekjen e procedurave në arkëtimin e tyre, për të cilat nuk është vepruar sipas dispozitave ligjore për arkëtimin e detyrimeve. Referuar Vendimit nr. 108., datë 14.09.2021 të kryetarit të KLSH-së, protokolluar në bashki me nr. 235/40 prot, datë 17.09.2021 Drejtoria e Financës ka bërë kontabilizimin në bazë të urdhër zhdëmtimeve përkatëse të dala nga Kryetari i Bashkisë sipas planit të veprimit, janë njoftuar OE, por nuk është vepruar sipas dispozitave ligjore për arkëtimin e detyrimeve. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 òKodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisëò nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 93.

Kriteri:

Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 òKodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisëò nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò

nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 93.

Ndikimi/Efekti:

Mos zbatimi i procedurave ligjore në arkëtimin e detyrimeve, çojnë në mungesë të ardhurash për Bashkinë Kuçovë në shumën **159,400** mijë lekë,

Shkaku:

Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse në Bashkinë Kuçovë, në zbatimin e akteve ligjore/nënligjore

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Drejtoria e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën **159,400,036lekë**, të paraqitura në fund të periudhës 31.12.2021, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Kuçovë.

-Gjendja e llogarisë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta”** (debitorë) më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 30,149,047 lekë.Nga analiza e llogarisë **4342** òOperacione me shtetin, të drejta” për vitin 2021 është e analizuar si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2021
1	Paga Personeli Ilogaria 42	5,803,447
2	Tatim page tatim ne burim Ilogaria 431	411,976
3	Sigurimet Shoqërore Ilogaria 435	1,709,869
4	Sigurime Shëndetësore Ilogaria 436	237,290
5	Furnitorëllogaria.401-408	19,957,264
6	Kreditore të ndryshëm Ilogaria. 467	1,574,106
7	Organizma të tjera shtetore 438	52,875
8	Marëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike 45	402,202
	TOTALI	30,149,047

Nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara në 8 (tetë) llogarive pasive**, pra në vitin 2021 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

4.Nënrubrika, të tjera aktive afatshkurtra, gjendja e llogarisë **486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 147,448,183 lekë, kurse më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 122,386,433 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve e analizuar si vijon:

Emërtimi	Celje 01.01.2021	Shtesa	Pagesa	Gjendje 31.12.2021
Lëvizja e llogarisë 486	147,448,183	92,249,329	121,653,715	122,386,433

Burimi: Drejtoria e financës

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik.

II. Rubrika, aktivet afatgjata.

1.Nënrubrika, aktive afatgjata jo materiale, gjendja e llogarisë **202 “Studime dhe kërkime”**, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 17,152,484lekë, ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën

15,951,810 lekë, me ulje në vlerën 1,200,674 lekë e cila i përket vlerës së amortizimit e analizuar si vijon;

Emertimi		Vlera Historike	Amortizimi	Teprica Neto
Plani I Pergjithshem Vendor Perondi		4,185,600	1,828,139	2,357,461
Plani I Pergjithshem Vendor Perondi		1,046,000	535,412	510,588
Projekti Rik. rruges Kuçove - Ura Vajgurore	2016	6,235,200	3,191,588	3,043,612
Plani I Pergjithshem Vendor Kucove		9,300,000	5,538,546	3,761,454
Te tjera studime dhe kerkime		373,000	162,915	210,085
Studime dhe kerkime (te patrupezuara) Lumas		986,400	430,829	555,571
Studim, projektim parku industrial		6,240,000	726,960	5,513,040
Vlerat Totale		28,366,200	12,414,390	15,951,810

Burimi: Drejtoria e financës

Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime".

Situata:

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se në totalin e llog 202- *Studime dhe kërkime*", nga 7 projekte që janë në këtë llogari ka përfunduar vetëm për dy objekt, konkretisht *Projekti për rikonstruksionin e rrugës "Ura Vajgurore-Kuçovë"*. si dhe "Studim, projektim parku industrial drejtoria e financës nuk ka bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së projektit. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Kriteri:

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 *Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme* Aneksi 1 *Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik* **Pika 2. Klasa 2**, *aktivet afatgjata* (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: *Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm:*

a) *Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicioni financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:*

- *Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;*

- *Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).*

Aktivitet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM"

Kreu II. *Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme* **Pika 16/b. d** të cilat përcaktojnë: *Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:*

b) *Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:*

- *Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23); dhe*

- *Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).*

d) Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjata, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës "b" më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:
- Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjata; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23).

Ndikimi/Efekti: Nuk paraqet një panoramë të qartë të pasqyrave financiare.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë për sistemin e llogarive

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi:

Drejtorja e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë (202) "Studime dhe kërkime", duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e koston totale të objektit.

Titulli i Gjeties Pasqyrim jo real i vlerës së aktiveve në pasqyrat financiare.

Situata:

Llogaria 210 "Toka, troje, terrene", më 31.12.2020 paraqitet me vlerë 351,104 lekë ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 351,142 lekë e cila përfaqëson vlerën neto të trojeve në administrim e pronësi të Bashkisë Kuçovë. Nga analiza e Kësaj llogarie konstatohet se shtesat janë në vlerën 38 lekë që i korrespondon pronave të regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajonale të ASHK Kuçovë, por pa vlerë, si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur e analizuar sipas aneksit nr. 3 pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit..

Kriteri:

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.

Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Pika 6. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues,

Pika 11. Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Aneksi 1, "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", Pika 2. Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël). Nënpika 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2, Paragrafi - Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata jo materiale".

Pika 33. Llogaritë përkatëse në klasën 2 funksionojnë si më poshtë vijon:

a) Për shtesat nga rivlerësimi:

Do të debitohen llogaritë e klasës 2 të aktiveve afatgjata; dhe

Do të kreditohet llogaria 109 "Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve"

Ndikimi/Efekti:

Mungesa e rivlerësimit të aktiveve, sjell një pasqyrim jo real të vlerës së tyre në pasqyrat financiare.

Shkaku:

Nga ballafaqimi problematikës gjatë procesit të auditimit në terren, ndërmjet evidentimit të objekteve ndërtesa e konstruksione që pasqyrore DPZHT me ato që pasqyrore në kontabilitet nga Drejtoria e Financës, ka rezultuar se nuk janë ndërmarrë procedura për rivlerësim për shkak të kostos që kërkon kryerja e këtij shërbimi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nënpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (*ndërtesa e konstruksione*), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (*referuar tregut*), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (*rritje/ulje rivlerësimi*), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) òAktive afatgjata materialeò e llog.(109) òDiferenca nga rivlerësimiò.

Të ngrejë një grup pune me specialit të fushës, për kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Kuçovë, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.

Llogaria 211 "Pyje, Plantacione, kullota" më 31.12.2020 paraqitet me vlerë 0 lekë ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 351,142 lekë e cila përfaqëson vlerën neto të pyjeve në administrim e pronësi të Bashkisë Kuçovë. Nga analiza e Kësaj llogarie konstatohet se shtesat janë në vlerën 1 lekë që i korrespondon pronave të regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajoneve të ASHK Kuçovë por pa vlerë, si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Gjithashtu sipas urdhërit nr. 151 datë 19.07.2021 është ngritur òKomisioni për inventarizimin fizik të pyjeve e kullotaveò të Bashkisë Kuçovë për pronat e transferuara me **VKM nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave.."**, i janë kaluar në pronësi pyje e kullota (4600 ha, nga e cila pyll prej 3634 ha, djerrë me sip 277.7 ha, bimësi pyjore me sip 240.7 ha, inproduktive 88.3 ha, kullotë 360.1 ha, nuk është kryer asnjë veprim për hipotekimin dhe regjistrimin e tyre as në Drejtorinë Rajonale të ASHK Kuçovë dhe as në kontabilitet.

Sipas njësive administrative kjo sipërfaqe është ndarë:

Njësia Administrative Kozare me sipërfaqe 976.73 ha

Njësia administrative Perondi me sipërfaqe 328.86 ha

Njësia administrative Lumas me sipërfaqe 3741.33 ha

Llogaria (212) "Ndërtesa e Konstruksione", më 31.12.2021 paraqitet me vlerë historike 140,424,536 lekë dhe vlerë neto 105,364,697 lekë që përfaqëson vlerën neto të ndërtesave të objekteve në administrim e pronësi të Bashkisë Kuçovë, pakësimet janë në vlerën 35,059,839 lekë për normën e amortizimit vjetor + amortizimin e akumuluar dhe blerje të krijuara me pagesë në vlerën 9,397,669 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	140,424,536
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	9,397,669
Pakësime gjatë vitit 2021	35,059,839
Transferuar (K)	9,397,669
Gjendja në 31.12.2020 (D)	105,364,697

Titulli i Gjeties Pasqyrim jo real i vlerës së aktiveve në pasqyrat financiare.

Situata:

Nga analiza e Kësaj llogarie konstatohet se në llogarinë 212 "Ndërtesa e Konstruksione", janë kontabilizuar 61 objekte në vlerën 61 lekë që i korrespondon pronave të regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajoneve të ASHK Kuçovë, por pa vlerë, si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur e analizuar sipas aneksit nr. 4 pika nr. 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

Kriteri:

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 *õPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeõ*, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.

Ndikimi/Efekti:

Mungesa e rivlerësimit të aktiveve, sjell një pasqyrim jo real të vlerës së tyre në pasqyrat financiare.

Shkaku:

Nga ballafaqimi problematikës gjatë procesit të auditimit në terren, ndërmjet evidentimit të objekteve ndërtesa e konstruksione që pasqyronte DPZHT me ato që pasqyronte në kontabilitet nga Drejtoria e Financës, ka rezultuar se nuk janë ndërmarrë procedura për rivlerësim për shkak të kostos që kërkon kryerja e këtij shërbimi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nënpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (*ndërtesa e konstruksione*), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (*referuar tregut*), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (*rritje/ulje rivlerësimi*), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) *õAktive afatgjata materialeõ* e llog.(109) *õDiferenca nga rivlerësimiõ*.

- Të ngrejë një grup pune me specialit të fushës, për kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Kuçovë, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.

Llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", më 31.12.2021 paraqitet me vlerë historike 599,210,344 lekë dhe vlerë neto 487,145,939 lekë që përfaqëson vlerën neto të rrugve në administrim e pronësi të Bashkisë Kuçovë, pakësimet janë në vlerën 112,064,405 lekë për normën e amortizimit vjetor + amortizimin e akumuluar.

Llogari 214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune", më 31.12.2021 paraqitet me vlerë historike 2,974,713 lekë dhe vlerë neto 808,162 lekë, pakësimet janë në vlerën 2,166,551 lekë për normën e amortizimit vjetor + amortizimin e akumuluar.

Llogaria 215 "Mjet transporti", më 31.12.2021 paraqitet me vlerë historike 14,811,196 lekë dhe vlerë neto 5,140,116 lekë pakësimet janë në vlerën 9,671,081 lekë për normën e amortizimit vjetor + amortizimin e akumuluar.

Llogaria 218" Inventarë ekonomike", më 31.12.2021 paraqitet me vlerë historike 20,802,199 lekë dhe vlerë neto 6,661,237 lekë, shtesat janë në vlerën 577,800 lekë e cila sipas inventarizimit fizik i është ngarkuar personave përgjegjës të materialeve dhe pakësimet janë në vlerën 14,140,961 lekë për normën e amortizimit vjetor + amortizimin e akumuluar.

Llogaria (219) “Amortizimi AAGJM&AAJM”, me vlerë **150,207,916** lekë e krahasuar me periudhën 2020 paraqitet me shtesë vlere **35,309,309**lekë që i korrespondon amortizimit të akumuluar, në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 5 pika 3 bashkëlidhur Projektraportit të auditimit.

Rezulton se përlllogaritja e amortizimit të AAGJM është në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit përcaktuar në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò i ndryshuar, pika (36).

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 òHuadhënie e nën huadhënieò dhe 6 òPjesëmarrje në kapitalin e vetëò, nuk janë kryer veprime të tilla, për rrjedhojë gjendja e tyre në pasqyrat e pozicionit financiar, për vlerën kontabël historike **0 lekë**. Kjo llogari, periudhës objekt auditimi vitin 2021, nuk ka pasur shtesa ose pakësime.

Titulli gjetjes: Mos kontabilizimi i aksioneve të ndërmarjes Ujësjetllës Kanalizime Berat ó Kuçovë ShA në llogarinë 26 òAktive afatgjata financiareò

Situata:

Mbi kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitet 2021 rezultoi se: Bashkia Kuçovë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2021 paraqitet si aksionare me 34.68% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA ndërsa Bashkia Berat paraqitet me 65.32% si aksionare të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA, me NUIS..... e cila është shoqëri aksionare me objekt òShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyreò. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjisllacioni në fuqiò. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 876,860 dhe kapital në vlerë monetare prej 876,860,000 lekë. Referuar ekstraktit historik Bashkia Kuçovë zotron 304,073 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 304,073,000 lekë, ose 34,68 % të aksioneve në pjesëmarrje të Bashkisë Kuçovë në òUjësjetllës Kanalizime Berat SHA duke sjell një nënvlerësim të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalet e vetaò në vlerën 304,073,000 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrin nr. 64 datë 22.07.2014 òPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 òAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materialeò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 òTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò.

Gjithashtu Bashkia Kuçovë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit N, si SH.A. me NUIS ò.....e cila është shoqëri aksionere me objekt òOrganizimi i aktiviteteve sportive ne fushën e futbollit... Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtar dhe ndërkombëtarò. Numri i aksioneve është 3,500 me vlerë nominale 1000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3.500.000 lekë.

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Kuçovë në òK.N ò Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë 26 òPjesëmarrje në kapitalet e vetaò në kundërshtim me Urdhrin e Ministrin nr. 64 datë 22.07.2014 òPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 òAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomaterialeò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 òTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò *Për veprimet dhe*

mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. H.Sh me detyrë Drejtor në Drejtorin Ekonomik

Kriteri:

Urdhri i Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 òPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 òAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomaterialeò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 òTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò .

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiare viti 2021, të llog 26 òPjesëmarrje në kapitalet e vetaò, gjendje kjo e nën vlerësuar me vlerë 307,573,000 lekë.

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi.

Rëndësia:I lartë

Rekomandimi:

Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin si pjesëmarrjes 34,68 % të kapitalin me vlerë monetare 304,073,000 lekë, në òUjësjellës Kanalizime Berat SHA dhe 100% në kapitalin e aksioneve tek klub sport N.me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llog. 26 òPjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

4.Nënrubrika, investime.

Llogaria (230; 231) “Investime”, për (AAJM/AAM) sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrën e pozicionit Financiar për periudhën raportuese ushtrimore 2021 paraqiten me vlerë 301,330,325 lekë, ku nga vlera prej 129,876,800 lekë gjendje më 31.12.2020 kemi një shtesë për vlerën 171,453,525 lekë.

Për investimet e kryera gjatë vitit 2021 është debituar llogarinë (231) dhe kredituar llogaritë Klasa (4) Në fund të vitit me kapitalizmin e tyre është kredituar llogaria (231) dhe janë debituar llogaritë (20) dhe (21) òAktive afatgjataò. Gjendja e kësaj llogari është analizuar sipas aneksit nr. 6 pika nr. 3 bashkëlidhur Projektraportit të auditimit.

Titulli gjetjes:*Pasqyrimi i gabuar i llogarisë 231 “Investime”*

Situata:

Nga analiza e llogarisë 231 òInvestime në procesò rezulton se për 10 objekte në vlerë 230,167,491 lekë janë investime të viteve paraardhës respektivisht të viteve 2015-2020 të cilat janë marë në dorëzim nga ana e drejtorisë së PZHT për të cilat nuk është bërë sistemi i tyre nga llog (231) në llogarinë (213), sipas aneksit nr. 7 pika 3. bashkëlidhur Projektraportit të auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 òPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar dhe neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. H.Sh me detyrë Drejtor në Drejtorin Ekonomik*

Kriteri:

UMF nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 òPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar dhe neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò.

Ndikimi/Efekti:

Nuk paraqesin një situatë të saktë të llogarive të pasqyrave financiare

Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit, si dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi:

Drejtoria e financës të marrë masa për sisteminin në kontabilitet të llogarisë (231) në llogaritë (213) ose (213), sipas objekteve pasi një pjesë e tyre janë mbyllur dhe duhet të kapitalizohet në aktive afatgjata materiale.

I. **Rubrika, pasivet afat shkurtra.**

1.Nën rubrika, llogari të pagueshme, gjendja e llogarive të 401-408 ÷Furnitorë dhe llogari të lidhura me toë , të 42 ÷Personeli e llogari të lidhura me toë, -të 431 ÷Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksaö, të 435 ÷Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqëroreö, të 436 ÷Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqëroreö, të 467 ÷Kreditore të ndryshëmö, të 438 ÷Organizma të tjera shtetëroreö, janë të barabarta me gjendjen e llogarisë 4342 ÷Operacione me shtetinö në vlerën **30,149,047** lekë për vitin 2021 e analizuar si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2021
1	Paga Personeli llogaria 42	5,803,447
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	411,976
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	1,709,869
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	237,290
5	Furnitorëllogaria.401-408	19,957,264
6	Kreditore të ndryshëm llogaria. 467	1,574,106
7	Organizma të tjera shtetërore 438	52,875
8	Marëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike 45	402,202
	TOTALI	30,149,047

Nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara në 8 (tetë) llogarive pasive,** pra në vitin 2021 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

-Gjendja e llogarisë 401-408 ÷Furnitorë e llogari të lidhura me toë , në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 1,238,021 lekë ndërsa në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 19,957,264 lekë, të cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj të tretëve më 31.12.2021. Gjendja e llogarisë (401-408) ÷Furnitorë e llogari të lidhura me toë, përbëhet nga fatura të palikujduara për detyrime në (investime/mallra) të muajit Nëntor-Dhjetor, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës.

-Gjendja e llogarisë 42 **“Detyrime ndaj personelitö** në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 5,803,447 lekë e cila paraqet detyrimet për pagat e punonjësve për muajin dhjetor 2021, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës

-Gjendja e llogarisë **431 “Detyrime ndaj shtetit tatim taksaö** në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 411,976 lekë detyrimet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për muajin dhjetor 2021, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës

-Gjendja e llogarisë **435 “Sigurime shoqëroreö** në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 1,709,869 lekë detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore për muajin dhjetor 2021, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës

-Gjendja e llogarisë **436 “Sigurime shëndetësoreö** në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 237,290 lekë detyrimet për kontributin e sigurimeve shëndetësore për muajin dhjetor 2021, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës

Krahasuar me list pagesat e muajit dhjetor të vitit 2021 dhe me evidencën e shpenzimeve të muajit janar të vitit 2020, vlerat e llogarive 42, 431, 435, 436 rakordojnë dhe janë të njëjta me përmbledhësen e listë pagesave dhe evidencën e shpenzimeve.

-Gjendja e llogarisë 466 **“Kreditorë për mjete në ruajtje”**, më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 16,077,594 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 10,390,253 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga analiza të llogarië, **konstatohet se: me shkresë nr. 2759 prot., datë. 20.08.2021 janë njoftuar subjektet për të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm për kthimin e garancisë së objekteve nga ku rezulton se:**

- a. *Vlera prej 596,540 lekë i është kthyer subjekteve;*
- b. *Vlera prej 4,896,132 lekë është sekuestruar dhe është kthyer në të ardhura për bashkinë sipas VKB nr. 72, dt. 29.10.2021.*

-Llogaria 467 **“Kreditorë të ndryshëm”** më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 153,848,743lekë dhe më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 123,960,540 lekë me një ulje në vlerën (29,888,203) lekë e cila është e zbërthyer në mënyrë analitike, për Bashkinë Kuçovë dhe Njësitë Administrative në varësi. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlera debitorë e kësaj llogarie, është e **kuadruar me shumën e llogarive kreditore në Aktiv të bilancit, respektivisht llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në vlerën **122,386,434 lekë** si dhe llogarinë 4342 **“Operacione me shtetin (Të drejta)”** në vlerën **1,574,106 lekë**, të cilat janë faturat që nuk i ka kaluar afati 60 ditëor. *Veprimet e mësipërme janë në përputhje të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik.*

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Për vitin 2021 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiakë nr.88, datë 16.12.2021 **“Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe tënjësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Kuçovë për vitin 2021** ò. Miratuar në total numri 379 + 5 punonjës të QKB dhe Gjendjes Civile = 384 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 375 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Kuçovë është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiakë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve janar 2021, shtator 2021 dhe janar 2022 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimit të miratuar.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës znj. H.Sh dhe Specialisti i pagave.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari Bashkisë; Z. K.H

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjëse i Burimeve Njerëzore z. K.L

Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkuara nga përpiluesi, për vitin 2019- 31.12.2021.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe shtator të vitit 2021) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkuara nga z. K.L përgjegjësi i burimeve njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,ò Kodi i Punësö, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Kuçovë, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 òPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSHö.

Mallra dhe shërbime (llogaria 602)

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Në analizë: Në formatin nr. 2 “Pasqyra e përformancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara PF për vitin 2021, e analizuar sipas aneksit nr. 8 pika 3 bashkëlidhur Projektraportit të auditimit.

Referuar aneksit të sipërcituar paraqiten llogaritë financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2021 (grant) në vlerën **451,580,857 lekë**. Të ardhurat e realizuara nga kjo njësi vendore në vlerën **631,881,771 lekë** sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Kuçovë. **Perfshirja në kete format të PF e gjendjes të të ardhurave sipas llogarive analitike është bërë nga jashte sipas ditarit të azhornuat nga drejtoria e taksave e tarifave vendore.**Gjendja e seciles llogari te te ardhurave rakordon me vlerat e paraqitura ne llogarite analitike te aktit te rakordimit me Degën e Thesarit Kuçovë

Për vitin 2021 totali i të ardhurave në vlere është **631,881,771 lekë** dhe totali shpenzimeve është në vlerën **451,580,857 lekë**. Diferenca e tyre në vleren **56,562,100 lekë** rakordon me gjendjen e llog.85 **“Rezultatit e ushtrimit”**

Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.

Bashkia Kuçovë për vitin 2021 nuk ka hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë pasi në periudhën e auditimit nuk ishte përmbushur afati ligjor. Veprimet janë në respektim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollitö; neni 9,pika 4, germa ödö, neni 12 pika 2. germa öbö

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollitö, neni 9, pika 4, germa ödö dhe neni 12, pika 2, germa öbö. UMF nr. 8, datë 9.03.2018 òPër procedurat e

përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli II, pikat 98; 99; 100; 101, germa öbö,pika 118.
(Për problemet e mësipërme është mbajtur akt-konstatimin nr. 4, datë 22.04.2022)

Të ndryshme të dala gjatë auditimit

4. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Nga verifikimi rezultoi se Kontrolli i Lartë i Shtetit në përmbushje të detyrave funksionale mbështetur në shkronjat (a) dhe (b) të nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ka përcjell në Bashkinë Kuçovë 2 Vendime, respektivisht;

- 1. Vendimin nr. 95., datë 05.08.2021, i Kryetarit të KLSH-së mbi “Auditimin Financiare, të Pasqyrave Financiare Viti 2020”, dërguar në bashkinë Kuçovë me shkresën nr. 678/35 datë. 05.08.2021*
- 2. Vendimin nr. 108., datë 14.09.2021, i Kryetarit të KLSH-së mbi “Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë”, për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2020, dërguar në bashkinë Kuçovë me shkresën nr. 98/17 datë. 14.09.2021. Në mënyrë të përmbledhur zbatimi i detyrave të lëna paraqitet si vijon:*

Auditimin Financiare, të Pasqyrave Financiare Viti 2020

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim në **Bashkinë Kuçovë** mbi: öVerifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në vitin 2021, paraqitur me shkresën nr. 678/35 datë. 05.08.2021ö, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse.

-Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si; vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërbllimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore, vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, si IMTV, Komisioneve të Licencave, APP, e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Kuçovë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 678/35 datë. 05.08.2021, protokolluar me shkresën nr. 235/39 datë 10.08.2021. Në vijim të korespondencës Bashkia Kuçovë me shkresën nr. 2545 datë 27.07.2021 ka hartuar öPlanin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve mbi auditimin e pasqyrave financiareö dhe me shkresën nr. 2749 datë 18.10.2021 është kthyer përgjigje KLSH. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë **brenda 20 ditësh**, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe

funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Kuçovë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 678/35 datë. 05.08.2021 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 05.02.2022. Nga ana e Bashkisë Kuçovë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH. Pra nuk është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH janë shkelur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku përcaktohet se: ÷Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Për të cilën mban përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. K.H.

Verifikimi i zbatimi i rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, paraqitet si më poshtë:

a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 8 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4 masë organizative, janë në proces zbatimi 2 masa organizative dhe nuk janë zbatuara 2 masa organizative.

Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë", për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2020

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim në **Bashkinë Kuçovë** mbi: ÷Verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në vitin 2021, paraqitur me shkresën nr. 98/17 datë. 14.09.2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse.

-Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si; vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore, vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, si IMTV, Komisioneve të Licencave, APP, e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Kuçovë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. nr. 98/17 datë. 14.09.2021, ndërsa nga Bashkia Kuçovë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 235/41 Prot. datë 14.10.2022. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë **brenda 20 ditësh**, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Kuçovë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 98/17 datë. 14.09.2021 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 14.03.2022. Nga ana e Bashkisë Kuçovë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH. Pra

nuk është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH janë shkelur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku përcaktohet se: ÷Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.Për të cilën mban përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. K.H.

- Nga verifikimi rezulton se Bashkia Kuçovë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 98/17 datë. 14.09.2021, **nuk ka raportuar** në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ÷Për financat e vetëqeverisjes vendore, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë. Për të cilën mban përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. K.H.

Verifikimi i zbatimi i rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, paraqitet si më poshtë:

a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4 masa organizative, janë në proces zbatimi 5 masa organizative të cilat në mënyrë të zgjeruar janë trajtuar në akt konstatimet e datës 22.04.2022 dhe nuk janë zbatuara 7 masa organizative.

b. Për masat shpërblim dëmi janë rekomanduar 6 masa me vlerë 1,272 mijë lekë, deri me datë 22.04.2022, nuk është arkëtuar asnjë lekë. Edhe pse kanë kaluar mbi 6 muaj nga krijimi i grupit të punës sipas urdhrin nr. 3324 Prot datë 14.10.2021 Drejtoria e Financës ka bërë kontabilizimin e detyrimeve, si dhe ka nisur njoftimet subjektet debitorë si dhe nuk janë nxjerr urdhër ekzekutimet. Gjithashtu nga Bashkia Kuçovë nuk është hartuar padi civile për shpërblim dëmi ndaj Operatorit ekonomik.

c. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të janë rekomanduar që të analizohet një masë në vlerën 358,448 mijë lekë në shpenzime, e pranuar dhe pa zbatuar si dhe 2 masa me efekt në të ardhura në vlerën 98,951 mijë lekë e pranuar dhe në proces zbatimi.

Në mënyrë të detajuar realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar si vijon:

Titulli i gjetjes:*Puna e pa mjaftueshme e Bashkisë Kuçovë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 98/17 datë. 14.09.2021 si dhe shkresa me nr. 678/35 datë. 05.08.2021.*

Situata nr. 1*Auditimin Financiare, të Pasqyrave Financiare Viti 2020*

Për sa sipër në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 ÷Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit, me shkresën e saj nr. 678/35 datë. 05.08.2021 është përcjellë në Bashkinë Kuçovë **Vendimin nr. 95., datë 05.08.2021, i Kryetarit të KLSH-së** duke kërkuar marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve. Nga verifikimi rezultoi se pjesa më me peshë e tyre është e pazbatuar duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

A. Masa organizative:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Kuçovë 8 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4 masë organizative, janë në proces zbatimi 2 masa organizative dhe nuk janë zbatuara 2 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1.2. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se llogaria. (468) ÷Debitorë të ndryshëm e cila paraqitet në vlerën 167,809,137 lekë, përbëhet nga:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari (468)	
-Nga aludimi i KLSH	10,460,883
-Nga policia bashkiake	32,500
-Nga banesa të dhëna me qira	8,921,960
-Nga IVMT	31,850,000
-Nga Drejtoria e të Ardhurave	116,280,962
-Te tjera	262,832
Totali	167,809,137

Në lidhje me detyrimet debitorë të mësipërme, Drejtoria e Financës me shkresën përcjellëse nr. 3549, datë 17.10.2018 i është drejtuar Drejtorisë Juridike për ndjekjen e procedurave në arkëtimin e tyre, por nga kjo e fundit nuk është vepruar duke i lënë në heshtje dhe rënduar ndër vite llogarinë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 ÷Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë÷ nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ÷Për vetëqeverisjen vendore÷ nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik÷, pika 93.

1.2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 167,809,137 lekë, të paraqitura në fund të periudhës 31.12.2020, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Kuçovë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

1.2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të planit të veprimit të institucionit, sipas shkresës nr. 2545 prot., dt 27.07.2021 për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer nga KLSH drejtoria e financës ka rakorduar me drejtorit dhe sektorët e tjerë të Bashkinë. Gjendja e debitorëve për vitin 2021 rezulton si vijon:

Emërtimi i llogarive	Vlera			
	Gjendja 31.12.2020	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2021
Llogari (468)				
-Nga aludimi i KLSH	10,460,883	1,526,912	0	11,987,795
-Nga policia bashkiake	32,500	13,500	6,500	39,500
-Nga banesa të dhëna me qira	8,921,960	0	0	8,921,960
-Nga IVMT	31,850,000	2,750,000	500,000	34,100,000
-Nga Drejtoria e të Ardhurave	116,280,962	18,244,196	30,444,209	104,080,949
-Te tjera	262,832	7,000	0	269,832
Totali	167,809,137	22,541,608	30,950,709	159,400,036

Burimi: Drejtoria e Financës

Në proces zbatimi

1.2.3. Rekomandim mbas verifikimit:Drejtoria e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën **159,400,036 lekë**, të paraqitura në fund të periudhës 31.12.2021, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Kuçovë.

Menjëherë

2.3. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se llogaria (202), e cila paraqitet në shumën 17,152,484 lekë, përbëhet nga:

I.	Studime-Projektme	Shuma 2019
1	Plani Përgjithshëm Vendor Perondi	2,534,904
2	Plani Përgjithshëm Vendor Perondi	549,019
3	Plani Përgjithshëm Vendor Bashkia Kuçovë	4,044,574
4	Të tjera studime dhe kërkime	225,898
5	Studime dhe kërkime të pa trupëzuara	597,389
6	Projekt për rikonstruksionin e rrugës Ure Vajgurore-Kuçove	3,272,701
7	Projekt për rehabilitimin e parkut industrial	5,928,000
Totali i llogarisë(202)		17,152,484

Nga të dhënat e investimeve, në totalin e llog 202- *Studime dhe kërkime*", nga 7 projekte që janë në këtë llogari ka përfunduar vetëm për një objekt, konkretisht: ÷Projekti për rikonstruksionin e rrugës "Ura Vajgurore-Kuçovë". Nga Drejtoria e Financës nuk janë bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së projektit. Sipas Drejt. Financës një veprim i tillë nuk është kryer pasi ky segment rrugorë nuk është aset i Bashkisë Kuçovë, por i Autoritetit Rrugorë Shqiptar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ÷Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit, i ndryshuar, shkronja (b).

2.3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemin e llogarisë (202) ÷Studime dhe kërkime", duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

2.3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer nga KLSH, dhe sipas planit të veprimit, Bashkia Kuçovë i është dërguar shkresa me nr. 2995 prot., datë.13.09.2021, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për kalim në kontabilitet të aktiveve të trupëzuara projekti për "Rikonstruksionin dhe rikualifikimin urban të rrugës "Urë-Vajgurore-Kuçovë", duke qënë se ky objekt i përket Autoritetit Rrugor Shqiptar. Deri në momentin e verifikimit datë 22.04.2022 nuk është konfirmuar kalimi në kontabilitet. prandaj ky projekt është gjendje në llogarinë ekonomike 202 "Studime e kërkime".

Në proces zbatimi

2.3.3.Rekomandim mbas verifikimit: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemin e llogarisë (202) ÷Studime dhe kërkime", duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

Menjëherë

3.4. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se llogaria (26) ÷Aktive afatgjata Financiare, paraqitet me vlerë zero, vlerë e cila nuk qëndron, kjo pasi Bashkia Kuçovë në QKB paraqet aksione me 100% të Klubit të Futbollit ÷Nō me Nipt , e cila është aksionare me objekt ÷Organizim i aktivitetit sportiv në fushën e futbollit. Regjistri si klub në federatën Shqiptare të futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit. Bashkia Kuçovë është aksionere me vlerë 3,500,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% lekë/aksione pjesëmarrës të Bashkisë Kuçovë në ÷FK Nō sha, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të pasqyrave financiare viti 2020, më konkretisht në llogarinë (26) ÷Aktive afatgjata materiale”, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Urdhri e MF nr. 64, datë 22.7.2014 ÷Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabiliteti të Përmisuar, me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 ÷Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata Jo materiale, pika 55,56 dhe 57.

3.4.1. Rekomandimi: Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek KF Nme vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llog. 26 ÷Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

3.4.2. Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021 llogaria 26 ÷Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet në vlerën 0 lekë.

Pa zbatuar

3.4.3.Rekomandim mbas verifikimit: Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin si pjesëmarrjes 34,68 % të kapitalin me vlerë monetare 304,073,000 lekë, në ÷Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA dhe 100% në kapitalin e aksioneve tek klub sport Nme vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llog. 26 ÷Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2022

4.7. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se vlera e AAM/JM të paraqitura në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, nuk evidentojnë ÷vlerën reale të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Kuçovë nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK (5) ÷Aktive afatgjata materiale e aktive jo materiale, paragrafi ÷Trajtimet kontabël për aktive afatgjata materiale, pika (23-32) ÷Modeli rivlerësimit. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes, si dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar në gjendjen që pasqyron kontabiliteti llog.(212) ÷Ndërtesa e konstruksione për 251 (294-43) objekte (ndërtesa e konstruksione të ndryshme, etj) me vlerë 0 (zero) lekë e cila ka sjellë një situatë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet, në lidhje me vlerësimin e aktiveve. Gjithashtu për asnjë nga periudhat që nga momenti i bashkimit të ish komunave në një bashki, nuk është kryer inventarizimi i asteve që Bashkia Kuçovë ka të regjistruara në pasqyrat financiare, gjë e cila bëhet me evidente nga bashkia me ish komunat dhe nuk dihet me saktë si gjendje fizike e tyre, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 ÷Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, i ndryshuar, Kapitulli IV-Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, "Inventarizimi i aktiveve".

UMF nr. 08, datë 09.03.2018: Kap.(IV) ÷Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar, pika (105).

4.7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nënpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve

afatgjata materiale (*ndërtesa e konstruksione*), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (*referuar tregut*), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (*rritje/ulje rivlerësimi*), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) òAktive afatgjata materiale ò e llog.(109) òDiferenca nga rivlerësimi ò.

Të ngrejë një grup pune me specialit të fushës, për kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Kuçovë, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

4.7.2. Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi Bashkia Kuçovë nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi të òAktive afatgjata materiale e aktive jo materiale ò,

Pa zbatuar

4.7.3.Rekomandim mbas verifikimit: Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nënpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (*ndërtesa e konstruksione*), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (*referuar tregut*), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (*rritje/ulje rivlerësimi*), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) òAktive afatgjata materiale ò e llog.(109) òDiferenca nga rivlerësimi ò.

- Të ngrejë një grup pune me specialit të fushës, për kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Kuçovë, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

Situata nr. 2: Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë, për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2020

Për sa sipër në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 òTë drejtat dhe detyrat e KLSH-së ò, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit ò, me shkresën e saj nr. 98/17 datë. 14.09.2021 është përcjellë në Bashkinë Kuçovë **Vendimin nr. 108., datë 14.09.2021, i Kryetarit të KLSH-së** duke kërkuar marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve. Nga verifikimi rezultoi se *pjesa më me peshë e tyre është e pazbatuar duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, rikërkojmë të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:*

A. Masa organizative:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Kuçovë 16 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4 masë organizative, janë në proces zbatimi 5 masa organizative të cilat në mënyrë të zgjeruar janë trajtuar në akt konstatimet e datës 22.04.2022 dhe nuk janë zbatuara 7 masa organizative. Në mënyrë të detajuar masat organizative të cilat rikërkohen janë si vijon:

1.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile për kontratat e audituara dhe konkretisht: (Rikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftës; Ndërtim shtesë kati Biblioteka Kuçovë; Rikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetori; Rikonstruksion i kopshtit nr. 1; Rikonstruksion i rrugës òE. Bë Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi, në Bashkinë Kuçovë; Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori ò, Bashkia Kuçovë. (Ndryshimi i projektit nga AK); Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të paforizuara; Rikonstruksioni i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptian Kuçovë dhe banues në zona rurale; Rikualifikimi urban i lagjes 1 Maj; Rikonstruksion i shkollës së mesme 5 Tetori), rezultoi se projekt zbatimi dhe preventivi është hartuar nga administrata e

Bashkisë Kuçovë, nga inxhinierë të profileve të ndryshme të pa pajisur me licencën e projektimit. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.9.1998 òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.6/4 faqe 86-101 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë të merren masa që projekt preventivat e objekteve të planifikuar për tu zbatuar, të hartohen nga persona të pajisur me licencën përkatëse dhe nëse në administratën e bashkisë nuk gjenden persona te licencuar, shërbimi i projektimit të prokurohet në zbatim të legjislacionit të prokurimeve, me qëllim përfitimin e projekteve sa më cilësorë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

1.1.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar

Pa zbatuar

1.2.3. Rekomandim mbas verifikimit: Nga Bashkia Kuçovë të merren masa që projekt preventivat e objekteve të planifikuar për tu zbatuar, të hartohen nga persona të pajisur me licencën përkatëse dhe nëse në administratën e bashkisë nuk gjenden persona te licencuar, shërbimi i projektimit të prokurohet në zbatim të legjislacionit të prokurimeve, me qëllim përfitimin e projekteve sa më cilësorë.

Menjëherë

2.2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 12 procedurave prokurimi me vlerë kontrate 429,789 mijë lekë me TVSH, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriterëve jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me zërat e preventivit, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në pjesëmarrjen e ulët të OE. (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.6. faqe 46-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kuçovë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, duke vendosur kriterë sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.2.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar

Pa zbatuar

2.2.3. Rekomandim mbas verifikimit: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kuçovë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, duke vendosur kriterë sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

Menjëherë

3.3. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me kriterin për përvojë të mëparshme, NJP ka bërë formulim të gabuar, ku në të gjitha rastet për punë të ngjashme për një objekt të vetëm, është kërkuar **sa 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës**, në kundërshtim me nenin 26, pika 6, germa (a) të VKM-së me nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.6. faqe 46-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.3.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit e Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë, të marrë masa për procedurat që do prokurojë në vijim, të hartojë kriterin për punë të ngjashme në përputhje me rregullat e prokurimit publik, ku vlera për një objekt të vetëm duhet të jetë jo më e madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.3.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar

Pa zbatuar

3.3.3. Rekomandim mbas verifikimit: Njësia e Prokurimit e Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë, të marrë masa për procedurat që do prokurojë në vijim, të hartojë kriterin për punë të ngjashme në përputhje me rregullat e prokurimit publik, ku vlera për një objekt të vetëm duhet të jetë jo më e madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Menjëherë

4.4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, janë konstatuar copëzime të fondeve, praktikë kjo në kundërshtim me kuadrin rregullator. Për vitin 2018 janë 11 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt “Materiale për funksionimin e zyrës”, me vlerë 1,650 mijë lekë, si dhe 15 urdhra prokurimi me objekt “Blerje pjesë këmbimi bateri etj” me vlerë 1,711 mijë lekë. Për vitin 2019 janë 5 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt “Materiale për funksionimin e zyrës”, me vlerë 1,203 mijë lekë, si dhe 8 urdhra prokurimi me objekt “Blerje pjesë këmbimi bateri etj” me vlerë 1,308 mijë lekë. Për vitin 2020 janë 6 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt “Materiale për funksionimin e zyrës”, me vlerë 1,125 mijë lekë, si dhe 4 urdhra prokurimi me objekt “Blerje pjesë këmbimi bateri etj” me vlerë 1,144 mijë lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6. faqe 46-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.4.1 Rekomandimi: Titullari i AK, të ngrëjë grupe pune me specialistë të fushës për hartimin e fondit limit mbi bazën e kërkesave të Drejtorive/Sektorëve, duke bërë grumbullimin e tyre sipas grup mallrave, dhe përcaktimin e saktë të nevojave të institucionit dhe procedurës që do zhvillohet, duke respektuar kufijtë monetarë dhe llojin e procedurës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4.4.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar

Pa zbatuar

4.4.3. Rekomandim mbas verifikimit: Titullari i AK, të ngrëjë grupe pune me specialistë të fushës për hartimin e fondit limit mbi bazën e kërkesave të Drejtorive/Sektorëve, duke bërë grumbullimin e tyre sipas grup mallrave, dhe përcaktimin e saktë të nevojave të institucionit dhe procedurës që do zhvillohet, duke respektuar kufijtë monetarë dhe llojin e procedurës.

Menjëherë

5.11. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i fundit të kryer në Bashkinë Kuçovë, KLSH ka njoftuar Bashkinë Kuçovë me shkresën nr. 54/13, datë 18.06.2018. Bashkia Kuçovë për zbatim e rekomandimeve të KLSH, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 202/83 datë 09.07.2018, brenda afatit 20 ditore nga data e shkresës për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu është kthyer përgjigje dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve, veprime këto në përputhje të shkronjës (j) e nenit 15 dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitö.

Nga verifikimi i zbatimit të detyrave të lënë nga auditimi i fundit, u konstatua se:

a. Nga 11 masa organizative: janë zbatuar plotësisht 6 masa organizative dhe janë në proces zbatimi 3 masa me vlerë 63,335 mijë lekë, nga e cila arkëtuar vlera 11,362 mijë lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 51,973 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative respektivisht: (rekomandimi nr. 10 dhe 11).

b. Nga **13masa shpërblim** dëmi me vlerë **20,125 mijë lekë**, nga të cilat nuk është pranuar 1 masë në vlerën 2,401 mijë lekë, si dhe janë pranuar 12 masa në vlerën **17,328 mijë lekë**. Nga masat e pranuar është zbatuar **1** masa me vlerë **1,888 mijë lekë** dhe nuk janë zbatuar 11 masa me vlerë **16,140 mijë lekë**.

c. Janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Kuçovë t*u* kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendortë **vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e** masave administrative (dënim me gjobë), **për 3 mbikëqyrës** punimesh **1 kolaudator**, konkretisht:

- V.Ynën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.
- E.Mpërfaqësues ligjor i subjektit “A.sh.p.k.
- F.B,përfaqësues ligjor i subjektit “H.sh.p.k. .
- L.Vnën cilësinë e kolaudatores së punimeve.

Deri në datën e verifikimit datën 16.04.2021 nga nëpunësi autorizues nuk është kryer asnjë llojë procedure ligjore në vendosjen e masës administrative me gjobë sa më sipër (*Trajtuar më hollësisht në pikën III.7. faqe 105-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.11.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 54/13, datë 18.06.2018.. *õPër zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kuçovë, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të bëjë kontabilizimin dhe të nxjerrë urdhër-zhdëmtimeve për shumët e pakontabilizuar, respektivisht:*

a-Për **5 masa** organizative, në vlerë 51,973 mijë lekë konkretisht rekomandimet (*nr.1,6,8,10,11*);

b-Për **12 masa shpërblim** dëmi në vlerën **16,140 mijë lekë**, për të gjitha pikat e rekomanduara;

c- Vendosjen e masës disiplinore “**Vërejtje me paralajmërim**”, për 16 punonjës që regullojnë mardhëniet sipas *õKodit të Punës në Republikën e Shqipërisë*.

d-I rikërkojmëKryetarit të Bashkisë Kuçovë t*u* kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendortë **vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e** masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara për **4 persona**, konkretisht:

1. V.T, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.
2. E.M, përfaqësues ligjor i subjektit “A.sh.p.k.
3. F.B,përfaqësues ligjor i subjektit “H.sh.p.k. .
4. L.V, në cilësinë e kolaudatores së punimeve.

Menjëherë

5.11.2. Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar

Pa zbatuar

5.11.3. Rekomandim mbas verifikimit: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 54/13, datë 18.06.2018.. *õPër zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kuçovë, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të bëjë kontabilizimin dhe të nxjerrë urdhër-zhdëmtimeve për shumët e pakontabilizuar, respektivisht:*

a-Për **5 masa** organizative, në vlerë 51,973 mijë lekë konkretisht rekomandimet (*nr.1,6,8,10,11*);

b-Për **12 masa shpërblim** dëmi në vlerën **16,140 mijë lekë**, për të gjitha pikat e rekomanduara;

6.12. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Kuçovë nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, konkretisht:

- Në Bashkinë Kuçovë nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe ka mangësi të plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.
- Institucioni për vitet 2018-2020 ka operuar pa rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Kuçovës.
- Bashkia Kuçovë për vitet 2018-2020 ka vepruar pa patur të hartuar dhe miratuar Kodin e Etikës Profesionale.
- Për vitin 2020 në Bashkia Kuçovë nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik edhe pse në Ministrinë e Financave në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është raportuar nëpërmjet pyetësorit të plotësuar, ekzistenca e një GMS të ngritur me urdhër nga titullari.
- Për periudhën 2018-2020 GSM i Bashkisë Kuçovë nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë institucionale me afat jo më pak se sa 5 vjet.
- Nga ana e titullarit nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut për vitin 2018, 2019 dhe 2020, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.
- Gjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020, ndryshimet në strukturën organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës.
- Për periudhën 2018-2020 Bashkia Kuçovë në funksion të kontrollit dhe menaxhimit të veprimtarisë financiare si dhe vjeljes së të ardhurave për tatim taksat lokale, nuk ka aplikuar asnjë program elektronik.
- Bashkia Kuçovë përveç periudhë 23.04-01.08.2019, për periudhën objekt auditimi 2018-2020 nuk ka emëruar koordinatorin e riskut, megjithëse janë hartuar regjistrat e riskut përkatës.
- Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, Ndërkohë për minimizimin e riskut, mashtrimin dhe parregullsitë, nga nëpunësi autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.
- Nga ana e nëpunësit autorizues nuk janë përcaktuar rregulla me shkrim mbi veprimtarinë e kontrollit dhe ndarja e detyrave në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin (*Trajtuar më hollësisht në pikën III.3. faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.12.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues dhe Kryetarit të GMS-së, si dhe Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrin masa të menjëhershme në funksion:

- Të hartojë një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimin të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësisë dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.
- Të merren masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, emërimin e koordinatorit të riskut, të hartohet Strategjia e menaxhimit të riskut, regjistri i riskut, planet e zhvillimit strategjik institucional si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore

të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

- Bashkia Kuçovë, të hartojë Rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Kuçovës dhe Kodin e Etikës Profesionale.

Brenda 3(tre) muajve nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit

6.12.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar

Pa zbatuar

6.12.3. Rekomandim mbas verifikimit: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit si dhe miratimin e gjurmëve të auditimit.

-Drejtorja e Burimeve Njerëzore të mari masa për përditsimin e rregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë

7.13. Gjetje nga auditimi: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Kuçovë konstatohet se :

- Për periudhën e auditimit 2018-2020 Drejtuesit e njesisë së Auditit të Brendshëm nuk kanë hartuar Kartën e Auditimit.
- Planifikimi vjetor i auditimeve për vitin 2019, është dërguar jashtë afatit në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.
- Raportimi vjetor për vitin 2018 nuk është përgatitur dhe dërguar në DHAB.
- Përgjegjësit dhe specialistët e NJAB në Bashkinë Kuçovë janë emëruar duke qenë të pa pajisur me certifikatën e audituesit.
- Në Bashkinë Kuçovë për periudhën 2018-2020 nuk janë çelur as manualisht as elektronikisht dosjet e përhershme të auditimit.
- NJAB në Bashkinë Kuçovë nuk ka planifikuar auditim të prokurimeve publike që janë zhvilluar në Bashkinë Kuçovë referuar nivelit të riskut dhe materialitetit (*Trajtuar më hollësisht në pikën III.3. faqe 21-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e NA, si dhe struktura e NJAB

- Të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në një nga format e përshtatshme që përcakton kuadri ligjor.
- Drejtuesi i Njesisë së Auditit të Brendshëm, të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditit.
- NJAB, të marrë masa për hartimin në kohë të Planifikimi vjetor dhe Raportimin vjetor të auditimeve dh dërgimin në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.
- NJAB në Bashkinë Kuçovë të planifikoj auditimet të prokurimeve publike që janë zhvilluar në Bashkinë Kuçovë, referuar nivelit të riskut dhe materialitetit.
- Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të marrë masa për të emëruar në NJAB punonjës të certifikuar në AB si dhe të filloj proceduat për certifikimin e punonjësve aktuale të NJAB.

Menjëherë

7.13.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar

Pa zbatuar

7.13.3. Rekomandim mbas verifikimit: - Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të marrë masa për plotësimin e organikës së Auditimit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin.

- Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.

- Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Kuçovë

Menjëherë

B. Masa për shpërblim dëmi

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit nën 15 shkronja (b) dhe (c) - *Të drejtat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 për vetëqeverisjen vendore, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,272,428 lekë**, si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi se vlera **1,272,428 lekë** është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 ódebitorë të Pasqyrave Financiare më datën 11.12.2021 (bilanci vjetor 2021) vlera prej **1,272,428lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej **1,272,428 lekë** Deri më datën 22.04.2022 nuk është arkëtuar asnjë lekë.

Në mënyrë tabelore rekomandimet, arkëtimet dhe natyra e rasteve të mos realizimit paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Nr	Emër Mbiemër/Subjekti	Numri rekomandimit sipas shkre (Vendimit)	Natyra e Shkeljes	Rekomanduar Gjithsej në Lekë	Nuk Pranohen nga Subjekti	Janë pranuar Në lekë	Nga të pranuarat:			
							Arkëtuar Deri 15.04.21	Në Proces Arkëtim	Në Proces Gjyqësor	Nisur Njoftime e s'kanë Paguar
a	b	c	d	1	2	3 (2-1)	4	5	6	7
1	A.sh.p.k.	1.1	Punimeve të pakryera.	132,297			0			po
2	Z.sh.p.k.	2.1	Punimeve të pakryera.	450,358			0			Po
3	F.sh.p.k.	3.1	Punimeve të pakryera.	26,940			0			po
4	DT.sh.p.k.	4.1	Punimeve të pakryera.	128,120			0			po
5	F.sh.p.k.	5.1	Punimeve të pakryera.	157,669			0			po
6	E.sh.p.k.	6.1	Punimeve të pakryera.	377,044			0			po

1.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *ËRikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftës* Bashkia Kuçovë, me vlerë 19,104,270 lekë me TVSH, fituar nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive òAò SHPK, & òBò SHPK përfaqësuar nga òAò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe konkretisht: “*Transport mbeturinash 5 km*”; “*Hekur shiriti tokëzimit*”, “*Elektroda tokëzimi*” dhe “*Lyrje me bojë sip metalike*”, në vlerën **132,297** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1807 prot datë 23.05.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë dhe Kontraktorit BOE òAò SHPK & òBò SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4/4. faqe 86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **132,297** lekë pa TVSH nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive òAò SHPK, & òBò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1807 prot, datë 23.05.2018 me objekt *ËRikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftës*, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

1.1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të shkresës nr. 3324 prot., dt. 04.10.2021 për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer nga KLSH, nga ana e bashkisë Kuçovë ka dalë urdhri i brendshëm i titullarit nr. 6, dt. 14.01.2022 dhe subjekteve u është dërguar njoftimi i detyrimit dhe fatura për arkëtim me shkresë nr.199 prot., datë 20.01.2022. Detyrimi nuk është arkëtuar.

Në proces zbatimi

1.1.3. Rekomandim mbas verifikimit: Bashkia Kuçovë, të merren masa duke ju drejtuar gjykatës për arkëtimin e vlerës prej **132,297** lekë pa TVSH nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive òAò SHPK, & òBò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1807 prot, datë 23.05.2018 me objekt *ËRikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftës*

Menjëherë

2.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *ËNdërtim shtesë kati Biblioteka Kuçovë* Bashkia Kuçovë, me vlerë 7,181,786.76 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësit të punimeve òZò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe konkretisht: *ËStruktura monolite betoni C 20/25 (kollona + soletë)*”, “*Kasetë shkarkimi bakri për ullukun t=1 mm*”, “*Ulluk shkarkimi vertikal bakri Ø120 mm*”, në vlerën **450,358** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3871 prot datë 14.11.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë dhe shoqërisë òZò SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4/4. faqe 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **450,358** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve òZò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3871 prot, datë 14.11.2018 me objekt *ËNdërtim shtesë kati Biblioteka Kuçovë*, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

2.2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të shkresës nr. 3324 prot., dt. 04.10.2021 për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer nga KLSH, nga ana e bashkisë

Kuçovë ka dalë urdhri i brendshëm i titullarit nr.11, dt. 14.01.2022 dhe subjekteve u është dërguar njoftimi i detyrimit dhe fatura për arkëtim me shkresë nr.199 prot., datë 20.01.2022. Detyrimi nuk është arkëtuar.

Në proces zbatimi

2.2.3. Rekomandim mbas verifikimit: Bashkia Kuçovë, të merren masa duke ju drejtuar gjykatës, për arkëtimin e vlerës prej **450,358 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve òZò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3871 prot, datë 14.11.2018 me objekt òNdërtim shtesë kati Biblioteka Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt òRikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetoriò Bashkia Kuçovë, me vlerë 1,241,832 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësit të punimeve òFò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërit të punimeve òThemel e xokol betoni C 12/15ò, në vlerën **26,940 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2649 prot datë 10.08.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë dhe shoqërisë òFò SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4/4 faqe 91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **26,960 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve òFò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2649 prot, datë 10.08.2020 me objekt òRikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetoriò, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të shkresës nr. 3324 prot., dt. 04.10.2021 për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer nga KLSH, nga ana e bashkisë Kuçovë ka dalë urdhri i brendshëm i titullarit nr.10, dt. 14.01.2022 dhe subjekteve u është dërguar njoftimi i detyrimit dhe fatura për arkëtim me shkresë nr.199 prot., datë 20.01.2022. Detyrimi nuk është arkëtuar.

Në proces zbatimi

3.3.3. Rekomandim mbas verifikimit: Bashkia Kuçovë, të merren masa duke ju drejtuar gjykatës, për arkëtimin e vlerës prej **26,960 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve òFò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2649 prot, datë 10.08.2020 me objekt òRikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetoriò, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Menjëherë

4.4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt òRikonstruksion i kopshtit nr. 1ò Bashkia Kuçovë, me vlerë 8,003,586 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve, bashkimi i përkohshëm i shoqërive òDHò SHPK& òTò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve: òTermoizolim solete me polisterol t=25 cmò; òKasetë shkarkimi bakri për ullukun t=1 mmò; òUlluk shkarkimi vertikal bakri Ø120 mmò; òF.V Dyer të brendshme druri importi cilësi e I-rëò, në vlerën **128,120 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3040 prot datë 12.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë dhe JV òDHò SHPK& òTò SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4/4. faqe 92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **128,120** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve JV òDHò SHPK& òTò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3040 prot, datë 12.09.2018 me objekt òRikonstruksion i kopshtit nr. 1ò, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

4.4.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të shkresës nr. 3324 prot., dt. 04.10.2021 për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer nga KLSH, nga ana e bashkisë Kuçovë ka dalë urdhri i brendshëm i titullarit nr.7, dt. 14.01.2022 dhe subjekteve u është dërguar njoftimi i detyrimit dhe fatura për arkëtim me shkresë nr.199 prot., datë 20.01.2022. Detyrimi nuk është arkëtuar.

Në proces zbatimi

4.4.3. Rekomandim mbas verifikimit: Bashkia Kuçovë, të merren masa duke ju drejtuar gjykatës, për arkëtimin e vlerës prej **128,120** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve J.V òDHò SHPK& òTò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3040 prot, datë 12.09.2018 me objekt òRikonstruksion i kopshtit nr. 1ò, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Menjëherë

5.5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt òRikonstruksion i rrugës òE Bò Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi, në Bashkinë Kuçovë me vlerë 8,003,586 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve, bashkimi i përkohshëm i shoqërive òFò SHPK &òShò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve: òShtresë rëre t=10 cm nën tubò; òPllaka betoni gri t=6 cm për trotuarò; òShtresë stabilizanti t=5 cm nën pllakaò në vlerën **157,669 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 297 prot datë 24.01.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë dhe JV òFò SHPK &òShò SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4/4. faqe 94-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **157,669** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve J.V òFò SHPK &òShò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3040 prot, datë 12.09.2018 me objekt òRikonstruksion i rrugës òE.Bò Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi, në Bashkinë Kuçovë, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

5.5.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të shkresës nr. 3324 prot., dt. 04.10.2021 për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer nga KLSH, nga ana e bashkisë Kuçovë ka dalë urdhri i brendshëm i titullarit nr.8, dt. 14.01.2022 dhe subjekteve u është dërguar njoftimi i detyrimit dhe fatura për arkëtim me shkresë nr.199 prot., datë 20.01.2022. Detyrimi nuk është arkëtuar.

Në proces zbatimi

5.5.3. Rekomandim mbas verifikimit: Bashkia Kuçovë, të merren masa duke ju drejtuar gjykatës, për arkëtimin e vlerës prej **157,669** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve JV òFò SHPK &òShò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3040 prot, datë 12.09.2018 me objekt òRikonstruksion i rrugës òE.Bò Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi, në Bashkinë Kuçovë, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson

dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori”* Bashkia Kuçovë, me vlerë 74,580,437 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve, Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive òE.ò SHPK & òA.ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve: òPrishje mur tulle pa pastrim; òShtresë betoni C 7/10, t = 10 cm, nën themeleò, në vlerën **377,044 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2286 prot datë 04.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë dhe JV òE.ò SHPK & òA.ò SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4. faqe 95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **377,044** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve JV òE.ò SHPK & òA.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2286 prot, datë 04.07.2019 me objekt *“Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare 18 Tetori”*, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

6.6.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të shkresës nr. 3324 prot., dt. 04.10.2021 për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer nga KLSH, nga ana e bashkisë Kuçovë ka dalë urdhri i brendshëm i titullarit nr.7, dt. 14.01.2022 dhe subjekteve u është dërguar njoftimi i detyrimit dhe fatura për arkëtim me shkresë nr.199 prot., datë 20.01.2022. Detyrimi nuk është arkëtuar.

Në proces zbatimi

6.6.3. Rekomandim mbas verifikimit: Bashkia Kuçovë, të merren masa duke ju drejtuar gjykatës, për arkëtimin e vlerës prej **377,044** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve JV òE.ò SHPK & òA.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2286 prot, datë 04.07.2019 me objekt *“Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare 18 Tetori”*, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Menjëherë

D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 15 procedurave me vlerë 546,376 mijë lekë pa SHPK, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 11 procedura me vlerë kontrate 398,012 lekë ose 72.8 % e fondit të prokuruar, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **358,448 mijë lekë** pa SHPK, respektivisht:

1.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Rikonstruksioni i Rrugës “E.B”, fshati Rreth Tapi, Njësia Administrative Perondiò*, me fond limit 30,688 mijë lekë, me fitues BOE òFò SHPK & òShò SHPK me vlerë të ofertës 29,461 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos

plotësimi të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **29,461,240 lekë**.

1.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *ōRikonstruksion i shkollës së mesme 5 Tetoriō*, me fond limit 43,528 mijë lekë, me fitues BOE ãA.ō SHPK & ãBō SHPK me ofertë 42,664 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **42,664,066 lekë**.

1.3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *ōRikonstruksioni i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptiane Kuçovë dhe banues në zona ruraleō*, me fond limit 12,319 mijë lekë, me fitues OE ãZō SHPK me ofertë 12,145 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **12,145 mijë lekë**.

1.4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Rikualifikim i lagjes 1 Maj”*, me fond limit 90,747 mijë lekë, me fitues BOE ãAō SHPK & ãBō SHPK me ofertë 88,015 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **88,015 mijë lekë**.

1.5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Shërbim i dekorit në Bashkinë Kuçovë”*, me fond limit 7,870 mijë lekë, me fitues OE A. D. p.f me ofertë 7,869 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **7,869 mijë lekë**.

1.6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *ōNdërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetoriō*, me fond limit 64,093 mijë lekë, me fitues BOE ãE.ō SHPK & ãA.ō SHPK me ofertë 62,150 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **62,150,364 lekë**.

1.7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *ōDevijim i përroit Gegë për zgjerimin e varrezave publikeō*, me fond limit 15,182 mijë lekë, me fitues OE ãFō SHPK me ofertë 14,899 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **14,899 mijë lekë**.

1.8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *ōRikonstruksion i rrugës Murat Daulleō*, me fond limit 37,650 mijë lekë, me fitues BOE ãFō SHPK & ãShō SHPK & ãC.ō SHPK me ofertë 36,936 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **36,936 mijë lekë**.

1.9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Rikualifikim urban i lagjes Llukan Priftiō*, me fond limit 65,621 mijë lekë, me fitues BOE ãFō SHPK & ãShō SHPK me ofertë 64,303 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **64,303 mijë lekë**. *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.6. faqe 54-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

1.1.(1-11) Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **358,448 mijë lekë** pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator

në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

1.11.2. Nga verifikimi rezultoi se: Ku rekomandim do të konsiderohet i pa realizuar

Pa zbatuar

1.11.3. Rekomandim mbas verifikimit: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **358,448 mijë lekë** pa tvsh. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

2.3. Gjetje nga auditimit: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Kuçovë për periudhën objekt auditimi nuk ka arkëtuar detyrimet e kontratave dhe kamatvonesat nga 155 fermerë në vlerën **13,527,645 lekë**, që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë, (detyrim kontrate viti 2017 e para në vlerën 642,188 lekë, viti 2018 në vlerën 960,488 lekë dhe viti 2019 në vlerën 981,906 lekë dhe kamatvonesa në vlerën 10,943,063 lekë). (*Trajtuar më hollësisht në pikën III.4. faqe 29-30 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

2.3.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të Sektorit të Bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, në shumën prej **13,527,645 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi drejtoria e të Ardhurave nuk ka krijuar një regjistër analitik, çka do të thotë që informacioni nuk jep siguri të arsyeshme

Pa zbatuar

1.2.3. Rekomandim mbas verifikimit: Drejtorinë e Taksave Vendore të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të Sektorit të Bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, në shumën prej **13,527,645 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

Menjëherë

Kriteri:

Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 (Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit nëni 15, (Të drejtat e KLSHö, germa j), Shkresa Nr.98/17 datë. 14.09.2021 si dhe Shkresa Nr.678/35 datë. 05.08.2021 (Për zbatimin e rekomandimeve, në Bashkinë Kuçovë)

Shkaku:

Mos ndjekja e gjitha procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës 1,272 mijë lekë

Ndikimi/Efekti:

Ndikon në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Kuçovë.

Rëndësia: *E Lartë*

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Kuçovë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresat Nr. 98/17 datë. 14.09.2021 dhe shkresat Nr. 678/35 datë. 05.08.2021 duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune

të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre, *respektivisht*:

a-Për 11 masa organizative, konkretisht sipas shkresës nr. 98/17 datë. 14.09.2021 rekomandimet nr. (1,2,3,4,11,12 dhe 13) dhe sipas shkresës nr. 678/35 datë. 05.08.2021 rekomandimet nr.(2,3,4 dhe 7)

b-Për 6 masa shpërbllim dëmi në vlerën 1,272 mijë lekë, për të gjitha pikat e rekomanduara;

c- Për një masë në vlerën 358,448 mijë lekë në shpenzime si dhe 1 masë në vlerën 13,527 mijë lekë në të ardhura.

5. Shqyrtim ankese

Në KLSH është administruar ankesa me nr. 404 prot, datë 14.04.2022, e subjektit òB.ò, për procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt òBlerje material për funksionimin e paisjeve të zyrës (Tонера), me vlerë të ofertës ekonomike 411,500 lekë lekë, me numër REF-22929-03-24-2022.

Në ankesë thuhet: OE òB.ò ka marrë pjesë në procedurën e mësipërme me vlerë të vogël dhe në datën 28.03.2022 është njoftuar nëpërmjet SPE për renditjen e ofertave në të cilën jemi reditur në vend të tretë me vlerë të ofertës ekonomike 289,500 lekë pa TVSh. Në datën 31.03.2022 kemi marrë njoftimin e fituesit në SPE. Në datën 01.04.2022 përfaqësuesi i òB.ò është paraqitur pranë AK me dokumentacionin e kërkuar dhe sasinë e mallit sipas kërkesave të AK. Bashkangjitur dokumentacionit të ankesës kemi bashkangjitur edhe foto të secilit produktë ofertuar.

Komisioni i marrjes në dorëzim të mallit, në shkelje të LPP nuk ka pranuar të marrë në dorëzim mallin me argumentin se malli nuk është në përputhje me specifikimet e vendosura në ftesën për ofertë.

Në ftesën për ofertë specifikimet teknike të vendosura janë:

1-Emërtimet e printerave në të cilat tonerat do të përdoren;

2-Tonerat të jenë me pullë sigurie, origjinalë ose ekuivalent i origjinalit, në të kundërt malli nuk do të pranohet;

3-Tonerat për printerat dhe fotokopjet duhet të jenë origjinal të prodhuesit të paisjeve ose ekuivalent dhe nuk duhet të jenë tonera të ricikluara apo të rimbushura;

4-Tonerat duhet të mbajnë pullën òGenuineò.

Nga fotot e dorëzuara dhe dokumentacioni i tenderit verifikohet se:

a-Tonerat e ofertuar janë tërësisht në përputhje me modelin e printerit sipas listës së produkteve të kërkuara nga AK.

b-Tonerat janë ekuivalente, jo të rimbushura dhe jo të ricikluara, vërtetuar me certifikatën e origjinës së mallit de autorizimin e prodhuesit me të cilin OE është i autorizuar ti tregtojë këto produkte.

c-Tonerat përmbajnë pullën e sigurisë sipas kërkesave të AK.

Nuk arrijmë të kuptojmë se çfarë ka dashur të thotë komisioni me shprehjen se ò Tonerat nuk janë sipas specifikimeve të vendosura në ftesën për ofertë. Cilin specifikim nuk plotësojnë tonera e ofertuar nga OE òB.ò?

Procesverbali i mbajtur nga komisioni është i pa rregullt, pasi nuk janë pasqyruar pretendimet e përfaqësuesit të OE òB.ò, si e kërkon ligji. Procesverbali është firmosur nga persona të ndryshëm nga ata që kanë bërë verifikimin në teren të produkteve, gjë e cila na bënë të dyshojmë se personat që kanë firmosur nuk kanë kapacitetin e duhur teknik për të bërë vlerësimin e këtyre mallrave.

Në procesverbal duhet të ishin shënuar se cilat specifikime nuk plotësonin mallrat një nga një dhe jo të shkruhej nga komisioni me një përgjithësim të tipit òMalli nuk plotëson kriteretò.

Bashkangjitur procesverbalit të komisionit duhet të ishin vendosur foto të produkteve të dorëzuara, duke shënuar se cilin prej specifikimeve teknike nuk plotësonte malli i dorëzuar. Përveç sa më sipër kemi vënë re një sërë parregullsish të kjo procedurë dhe procedura të mëparshme të realizuara nga ky AK, konkretisht:

- a) Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 24 OE dhe në mënyrë të pa shpjegueshme janë skualifikuar OE të renditur në vendin e 7, 12, 15, 1, të cilët kanë në objektin e QKB mallrat e kërkuara në këtë procedurë dhe janë mbi 50% të fondit limit.
- b) Operatori fitues ka fituar kontratën me 100% të fondit limi, duke lënë pas operatorë me eksperiencë mbi 20 vjeçare në treg.
- c) Në procedurën e vitit 2021 me referencë REF-94051-04-27-2021, me të njëjtin objekt, është shpallur fitues i njëjti OE me 100% të fondit limit.
- d) Edhe në procedurat e vitit 2020 dhe 2019 procedurat janë realizuar në limitet e fondit limit.

Përsa më sipër kërkojmë rivlerësimin e mallrave të ofertuara nga OE òB.ò, me një tjetër komision dhe shpalljen fitues të OE òB.ò, pasi vlerësojmë se shkeljet janë bërë me qëllim. Nga auditimi i dokumentacionit të skanuar të dërguar nga Bashkia Kuçovë, konstatohet: -Nga Kryetari i Bashkisë z K.H ka dalë urdhëri nr.19, datë 24.01.2022 për ngritjen e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël deri në datën 31.12.2022, i përbërë nga L.K. E.A, A.V. Ky komision në datën 24.03.2022 ka bërë llogaritjen e fondit limit për këtë procedurë prokurimi në vlerën 411,500 lekë, nëpërmjet marrjes së tre ofetave nga tregu. Në datën 23.03.2022 ka dalë urdhri i prokurimit nr.69, në të cilin është përcaktuar emërtimi dhe sasia e mallrave të kërkuara.

Gjithashtu në datën 23.03.2022 është hartuar ftesa për ofertë, në të cilën janë përcaktuar specifikimet teknike si vijon:

- Tonerat të jenë me pullë sigurie, duhet të jenë origjinalë ose ekuivalent i origjinalit, në të kundërt malli nuk do të pranohet;
- Tonerat për printerat dhe fotokopjet duhet të jenë origjial të prodhuesit të paisjeve ose ekuivalen dhe nuk duhet të jenë tonera të ricikluara apo të rimbushura;
- Tonerat duhet të mbajnë pullën “Genuine”.

Në ftesën për ofertë janë kërkuar si dokument për tu paraqitur nga OE vetëm formulari i ofertës. Pra nuk ka kritere të vendosura për tu plotësuar nga operatorët ekonomik, e për rrjedhojë as dokumenta për tu paraqitur prej tyre, por vetëm specifikimet e mësipërme. Në datën 28.03.2022 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël (njësia e prokurimit) ngritur me urdhrin nr.19, datë 24.01.2022 është mbajtur procesverbali për skualifikimin e operatorve ekonomik, në të cilin janë skualifikuar 7 OE për arsye se oferta e tyre ka qenë mbi vlerën e fondit limit, sipas listës në vijim:

1. J.G me nipt me ofertë 550.000. Lekë pa T.V.SH
2. A me nipt me ofertë 514.480 Lekë pa T.V.SH
3. Ame nipt me ofertë 520.100 Lekë pa T.V.SH
4. S.me nipt me ofertë 550.000 Lekë pa T.V.SH
5. O me nipt me ofertë 516.667 Lekë pa T.V.SH
6. D. me nipt me ofertë 539.000 Lekë pa T.V.SH
- 7.O. me nipt me ofertë 577.000 Lekë pa T.V.SH

Bazuar në udhëzimin nr.05, datë 25.06.2021 mbi procedurat me vlerë të vogël të zhvilluara në mënyrë elektronike pika 15, janë skualifikuar 3 OE sepse oferta e tyre është e ulur më shumë se 50% e fondit limit, si vijon:

- 1.L.me nipt me ofertë 127.777 Lekë pa T.V.SH .

2.I.me nipt me ofertë 155.630 Lekë pa T.V.SH .

3.A. me nipt me ofertë 127.777 Lekë pa T.V.SH

Bazuar në Udhëzimin nr 5 datë 25.06.2021 òMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj në mënyrë elektronike, pika 15 refuzimi i ofertave, sipas verifikimit që ka bërë komisioni i prokurimit me vlerë të vogël në Qendrën Kombëtare të Biznesit ka rezultuar se aktiviteti i tyre nuk përputhet me objektin e procedurës së prokurimit dhe për këtë arsye ka refuzuar ofertën për 4(katër) operator ekonomik si më poshtë:

1. J me nipt me ofertë 280.000 Lekë pa T.V.SH .

2. R. me nipt me ofertë 322.000Lekë pa T.V.SH .

3. A.me nipt me ofertë 400.000 Lekë pa T.V.SH .

4. Q. me nipt me ofertë 322.00 Lekë pa T.V.SH .

Pas skualifikimeve, operatorët ekonomik të kualifikuar janë si vijon:

1-P. vlera 218,600

2-Svlera 275,000

3-R. vlera 276,000

4-B. vlera 289,500

5-I.vlera 289,500

6-M. vlera 299,000

7-A.vlera 319,000

8-C. vlera 383,000

9-B.vlera 388,900

10-M.vlera 410,000.

Nga dokumentacioni konstatohet se OE P me vlerë të ofertës 218,600 ka njoftuar AK se tërhiqet nga gara për shkak të llogaritjes së gabuar të fondit limit.

AK nëpërmjet komisionit ka mbajtur procesverbal për këtë dhe ka njoftuar OE i renditur i dyti në radhë, që është që është S me vlerë 275,000 lekë, i cili ka njoftuar AK se tërhiqet nga gara për arsye personale. Nga AK është njoftuar OE R. me vlerë të ofertës 276,000 lekë, i cili ka njoftuar AK se tërhiqet nga gara për shkak të llogaritjes së gabuar të fondit limit.

Në vijim nga AK në datën 01.04.2022 është njoftuar OE òB.ò, i renditur i katërti në radhë me vlerë të ofertës 289,500 lekë, i cili ka paraqitur mallin pranë AK. Malli i dorëzuar është verifikuar nëse përputhet ose jo me specifikimet e përcaktuara në ftesën për ofertë, nga komisioni për marrjen e mallrave në dorëzim, i ngitur nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr.21, datë 24.01.2022 i cili përbëhet nga znj. A.B (Ing ndërtimi), znj.P.K(Juriste) dhe z.E.D (Kordinator për të drejtën e informi). Ky komision në datën 01.04.2022 ka mbajtur procesverbalin përkatës në të cilin është shprehur:

Pas verifikimit të tonerave rezuktoi se ata nuk ishin të gjithë sipas specifikimeve të vendosura në ftesën për ofertë. Përvec tonerit Xerox i cili ishte origjinal, tonerat e tjerë nuk janë origjinal, ose ekuivalent të origjinalit. Për këtë arsye malli nuk pranohet.

Procesverbai është mbajtur në prani të përfaqësuesit të OE òB.ò, i cili është shprehur në procesverbal se nuk është dakord me këtë konkluzion të komisionit.

Specifikimi teknik që tonerat të jenë origjinal, ose ekuivalent të origjinalit, është i vendosur në ftesën për ofertë.

Por nga mënyra se si është shprehur komisioni i marrjes në dorëzim të mallit, konstatohet se prej tij nuk janë dhënë shpjegime të hollësishme e të qarta se si u arrit në konkluzionin që tonerat e dorëzuara nga OE òBò nuk janë origjinal, pra çfarë verifikimesh konkrete u bënë nga komisioni për këtë qëllim.

Në ftesën për ofertë janë vendosur tre specifikime teknike dhe komisioni ka pasur detyrimin të verifikonte, në prezencë të operatorit ekonomik, nëse malli i dorëzuar prej tij i plotësonte këto tre specifikime teknike, duke i verifikuar ato një për një.

Në procesverbalin e mbajtur, komisioni duhet të kishte dokumentuar me imtësi se cilat prej tre specifikimeve teknike nuk plotësonte malli i dorëzuar nga OE òB.ò.

Komisioni nuk është shprehur nëse malli ka pullë sigurie ose jo dhe nëse kjo pullë është **“Genuine” (e vërtetë), ashtu si është kërkuar në ftesën për ofertë.** Për këtë arsye shfaqim rezerva mbi saktësinë e konkluzionit të komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, se tonerat e paraqitura nga OE òB.ò nuk plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.

Për mos dhënien e shpjegimeve të mësipërme ngarkohet me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim të mallit: znj. A.B, znj.P.K z.E.D.

Mbi bazën e procesverbalit të mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallit, nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla ne datën 01.04.2022 është mbajtur procesverbali me përmbajtje òmalli nuk ishte sipas ftesës për ofertë dhe është njoftuar OE òB.ò.

AK ka vijuar me njoftimin e OE të renditur i pesti në radhë, deri tek i nënti, të cilët nuk janë paraqitur dhe kanë bërë njoftim në sistem për AK, duke dhënë edhe shpjegime për këtë.

Si përfundim është shpallur fitues, pasi është pranuar malli nga Bashkia Kuçovë, OE M.i renditur i dhjeti në radhë, me vlerë të ofertës ekonomike 410,000 lekë. Për marrjen e mallit në dorëzim të OE fitues është mbajtur nga komisioni i marrjes së mallit në dorëzim, procesverbali i datës 12.04.2022.

Shqyrtimi nga Bashkia Kuçovë e ankesës së bërë nga OE “B.”.

Në datën 12.04.2022 është bërë shpallja e fituesit. Në datën 14.04.2022, OE òB.ò ka protokolluar ankesën pranë AK Bashkia Kuçovë, me nr. 1255 prot.

Në datën 14.04.2022 nga Kryetari i Bashkisë z. K.H, ka dalë urdhri i brendshëm nr.100, nr.1270 prot., për shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt òblerje material për funksionimin e paisjeve të zyrës (Tонера), të bërë nga OE òB.ò, për shqyrtimin e së cilës është caktuar z. E.C, me detyrë specialist IT.

Pas shqyrtimit të ankesës komisioni ka nxjerrë vendimin nr.1291 prot., datë 15.04.2022, në të cilin është shprehur:

òKomisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se përsa i përket pretendimit të ankimesit që produktet e sjella prej tij janë tonera tërësisht në përputhje me modelin e printerit sipas listës së produkteve të kërkuara nga AK, nga procesverbalet e administruara nga njësia e prokurimit dhe komisioni i marrjes në dorëzim vëren se mallrat objekt ankimi nuk janë mallra origjinal ose ekuivalent i origjinalit në cilësi dhe në paketim me arsyetimin se nga verifikimi i barkodeve të tonerave në prani të personit të autorizuar nga OE “B.”, rezultoi që këto barkode nuk ekzistonin sepse nuk hapej asnjë faqe në lidhje me to.

Kjo tregon që këto tonera nuk kanë cilësinë e kërkuar nga AK dhe nuk të japin sigurinë që duhet sipas ligjit që çdo produkt duhet të ketë barkod dhe në bazë të barkodit të verifikohet ligjshmëria e produkteve që janë në treg. Kjo tregon që letra ekuivalent mbi produktin është i ngjitur sipër kutisë nga operatori ekonomik ankimes, me qëllim kualifikimin e tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Akoma më tej, në argumentimin që ka mbajtur komisioni i marrjes në dorëzim në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “B.” se është i pajisur me autorizimin e prodhuesit për tregtimin e tonera nga Citrus Europe LTD, nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të kësaj kompanie eëë.citrusltd.com rezulton se kjo faqe nuk mund të hapet nga komisioni për verifikime të mëtejshme.

Gjithashtu në certifikatën e paraqitur nga operatori ekonomik “B.”, rezulton që OE nuk është i autorizuar për tonerat objekt prokurimi (origjinal ose ekuivalent) si më poshtë:

- *Ricoh sp 4510 sf pcl*
- *Ricoh sp 3600 sf pcl*
- *Ricoh mp c 3003 (set boje me ngjyra e zez, e kuqe, verdhë, blu)*
- *Ëork centre xerox 5021*
- *Samsung ML1665*
- *Xpress m2026*
- *Versolink C7025 (xerox)*
- *Toshiba studio 403s*
- *Samsung ML1640*
- *TOSHIBA E STUDIO 383P.*

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese nuk qëndron”.

Nga auditimi i vendimit të hartuar nga z. E.C për shqyrtimin e ankesë së bërë nga operatori ekonomik ðB.ö, kostatohet se:

- Z. E.C për të dalë në konkluzionin nëse malli i paraqitur nga OE ðB.ö është ose jo sipas ftesës për ofertë, nuk ka bërë verifikimin e mallit të këtij OE, pra nuk ka bërë krahasimin specifikimeve teknike të vendosura në ftesën për ofertë, me ato specifikime që kanë tonerat e dorëzuara nga OE ankimes.

Z. E.C ka dalë në konkluzionin se tonerat nuk plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, duke u mbështetur në fotot e mallit dhe të dhënat e tij të dorëzuar në ankesën e bërë nga OE, si dhe në procesverbalin që ka mbajtur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit dhe komisioni i blerjeve me vlera të vogla (i cili nuk përfshihet në dhënien e arsytimit mbi mallin, sepse vetëm ka njoftuar OE se malli i tij nuk plotëson specifikimet teknike, mbi bazën e procesverbalit të mbajtur nga komisioni për marrjen në dorëzim të mallit). Z. E.C në vendimin e hartuar prej tij, ka bërë përshkrime në emër të komisionit të marrjen në dorëzim të mallit, përshkrime të cilat në fakt nuk gjenden në procesverbalin e mbajtur nga ky komision.

Konkretish nga z. C thuhet se “...Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se ... nga procesverbalet e administruara nga njësia e prokurimit dhe komisioni i marrjes në dorëzim vëren se mallrat objekt ankimi nuk janë mallra origjinal ose ekuivalent i origjinalit në cilësi dhe në paketim me arsytimin se nga verifikimi i barkodeve të tonerave në prani të personit të autorizuar nga OE “B.”, rezultoi që këto barkode nuk ekzistonin sepse nuk hapej asnjë faqe në lidhje me to”.

Këto përshkrime të bëra nga z. C nuk janë pjesë e procesverbalit të hartuar nga komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, të cilit z. C i referohet.

Gjithashtunë vendimin e hartuar nga z. C thuhet se: *ð... në certifikatën e paraqitur nga operatori ekonomik “B.”, rezulton që OE nuk është i autorizuar për tonerat objekt prokurimi (origjinal ose ekuivalent)”. Ky interpretim i bërë nga z. C. është në tejkalim të kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë, sepse në këtë dokument nuk është kërkuar që operatorët ekonomik të paraqesin një certifikatë të tillë autorizimi nga prodhuesi (paraqitja e certifikatës hynë të kriteret dhe jo te specifikimet teknike, por një kriter i tillë nuk është kërkuar në ftesën për ofertë).*

Përderisa komisioni i marrjes në dorëzim të mallit ka pasur pretendime mbi faktin se mallrat e paraqitura nga OE ðB.ö nuk janë origjinale dhe kjo gjë është kundërshtuar nga vetë operatori ekonomik, atëherë ka qenë e nevojshme që nga z. E.C të verifikohet konkretisht ky mall dhe mbi këtë bazë të dilej në konkluzion nëse tonerat janë ose jo sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë (në bashkëpunim midis autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik ankimes, pasi ky i fundit është larguar pas refuzimit të mallit nga

komisioni). Konkluzionet e z. C nuk duhet të dilnin duke ju referuar konkluzioneve të komisionit të marrjes në dorëzim të mallit dhe fotove të mallit me të dhënat teknike, por duke shqyrtuar mallin e paraqitur nga OE dhe krahasimin e tij me specifikimet e përcaktuara në ftesën për ofertë..

Për arsyet e shpjeguara më sipër shfaqim rezerva mbi saktësinë e konkluzionit të nxjerrë nga z. E.C në vendimin e hartuar prej tij, nr.1291 prot., datë 15.04.2022, se mallrat e paraqitura nga OE òB.ò nuk plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në shqyrtimin e ankesës, ngarkohet me përgjegjësi z. E.C. Gjithashtu ka përgjegjësi edhe Kryetari i Bashkisë z. K.H, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor (AK), pasi ka miratuar vendimin e marrë nga z.C, në të cilin duket dukshëm se nuk është shqyrtuar malli i dorëzuar nga ankimuesi, pra ankesa e bërë nga OE òB.ò nuk është trajtuar si duhet.

Titullari i AK, duhet të mos miratonte përmbajtjen e shqyrtimit të ankesës të shqyrtuar nga z. C, por të kërkonte prej këtij të fundit këqyrjen (verifikimin) e mallit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm konstatohet se; Bashkia Kuçovë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, nuk është bërë përditësimi i saj duke mos reflektuar ndryshimet strukturore të bëra për periudhën objekt auditimi. Edhe pse janë miratuar regjistrat e riskut, bashkia nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh në njësinë vendore. Nuk janë hartuar programe për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafi si dhe nuk janë planifikuar pozicione me status *òkselentò*, si dhe pozicione me status *òGrup i veçantëò*, ku përfshihen 17 kategori të ndryshme. Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, nuk ka programe të licencuara e për rrjedhojë programet me të cilat punohet nuk garantojnë mbrojtjen e të dhënave të sistemit elektronik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, urdhrin e Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandim:Nga Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim identifikimin dhe menaxhimin e risqeve që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit. Të hartohet dhe miratohet gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës.

Deri më 31.10.2022

1.2.Rekomandim:Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për përditësimin e rregullores së brendshme, duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicion pune, si dhe të hartohet program për trajnimin dhe për ngritjen profesionale të stafit.

Deri më 31.10.2022

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm rezulton se Njësia e Auditit të Brendshëm ka ushtruar veprimtarine e saj me një, nga tre që detyron kuadri rregullator në fuqi. Nuk është realizuar numri i auditimeve konform planit vjetor dhe planeve strategjike të miratuar dhe nuk janë pasqyruar këto mosrealizime në planet vjetore për vitin 2021, nuk është hartuar karta e auditimit, nuk janë çelur as manualisht as elektronikisht dosjet e përhershme të auditimit, raportimi vjetor për vitin 2021 nuk është përgatitur dhe dërguar në DHAB si dhe nuk janë përcaktuar fushat me risk.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 òPër miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò, nenit 64, germa òaò të Ligjit nr. 139/2015 òPër Vetëqeverisjen Vendoreò. Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me urdhërin e ministrit të financave nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të marrë masa për plotësimin e organikës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, me tre auditues, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin.

Deri më 31.12.2022

2.2.Rekomandim:Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e kartës së auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë e të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit të AB.

Gjithashtu në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Kuçovë.

Deri më 31.10.2022

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 kanë diferenca me vlerën e planifikuar, pasi panifikimi i shpenzimeve ka vlerën 682,065,997 lekë, ndërsa realizimi vlerën 600,989,320lekë, ose në masën 88%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kuçovë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion për rishikimin e tij në lidhje me angazhimet e reja buxhetore, për të përshtatur trendin e shpenzimeve me trendin e të ardhurave faktike, si dhe për të mos krijuar detyrime të reja të prapambetura. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtorisë e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë nuk ka marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 151,289,512 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Nga kjo vlerë gjatë vitit 2021 është likuiduar vlera 106,747,689 lekë, ose 71% e detyrimit. Por gjatë vitit 2021 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 61,443,991 lekë, duke e çuar vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021 në 105,985,814 lekë, ose në masën 70% të detyrimeve në fillim të vitit buxhetor.

Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021, krahasuar me këtë vlerë në fillim të këtij viti ushtrimor është ulur në masën prej 30%.

Detyrimet e prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë nuk ka raportuar në MFE vlerën e plotë të detyrimeve të prapambetura. Vlera e raportuar në MFE në datën 31.12.2021 është 11,923,434 lekë, ndërsa vlera e detyrimeve të prapambetura të rakorduar me degën e thesarit dhe pasqyruar në pasqyrat financiare të bashkisë pa njësitë vartëse është 122,386,434 lekë. Duke përfshirë edhe detyrimet e njësisve vartëse, vlera totale e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kuçovë është 124,173,474 lekë.

Diferenca midis vlerës së detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE me vlerën e rakorduar me degën e thesarit është 112,250,040 lekë më pak në MFE, e pa raportuar në këtë të fundit, nga të cilat: 3,920,000 lekë janë detyrime për shpërblim lindje që financohen nga Ministria e Brendshme, 14,267,661 lekë janë detyrime për investime që financohen nga grand i kushtëzuar, për kontrata shumëvjeçare, 93,956,779 lekë janë detyrime për investime që financohen nga fondet e veta të Bashkisë, për kontrata shumëvjeçare, 105,600 lekë janë detyrime për investime që financohet nga fondet e veta të Bashkisë, nuk është likuiduar për mungesë dokumentacioni, detyrim i trashëguar nga ish komunat.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr.37, datë 06.10.2020 òPër monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshmeò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për raportimin në MFE për të gjitha detyrimet e prapambetura, pavarësisht burimit të tyre të financimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, rezulton se llogaria

468 òDebitorë të ndryshëmò paraqitet në vlerën 159,400,036 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2021. Në mënyrë analitike paraqitet në aneksin nr. 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga analiza e kësaj llogarie rezultojnë se Drejtoria e Financës me shkresën përcjellëse nr. 3549, datë 17.10.2018 i është drejtuar Drejtorisë Juridike për ndjekjen e procedurave në arkëtimin e tyre, për të cilat nuk është vepruar sipas dispozitave ligjore për arkëtimin e detyrimeve. Referuar Vendimit nr. 108., datë 14.09.2021 të kryetarit të KLSH-së, protokolluar në bashki me nr. 235/40 prot, datë 17.09.2021 Drejtoria e Financës ka bërë kontabilizimin në bazë të urdhër zhdëmtimeve përkatëse të dala nga Kryetari i Bashkisë sipas planit të veprimit, janë njoftuar OE, por nuk është vepruar sipas dispozitave ligjore për arkëtimin e detyrimeve. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 òKodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisëò nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 40-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandim:Drejtoria e Financës dhe Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën **159,400,036 lekë**, të paraqitura në fund të periudhës 31.12.2021, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Kuçovë.

Deri më 30.09.2022

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, rezultojnë se llogaria **202 "Studime dhe kërkime"**, paraqitet në vlerën 15,951,810 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultojnë se në totalin e llog 202- *Studime dhe kërkime*", nga 7 projekte që janë në këtë llogari ka përfunduar vetëm për dy objekte, konkretisht òProjekti për rikonstruksionin e rrugës "Ura Vajguore-Kuçovë". si dhe "Studim, projektim parku industrialò drejtoria e financës nuk ka bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së projektit. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Veprime dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshmeò dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 òPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, shkronja (b). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 40-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemin e llogarisë (202) òStudime dhe kërkime", duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 mbi kontabilizimin i AAM rezultojnë se: Llogaria 210 "Toka, troje, terrene", më 31.12.2020 paraqitet me vlerë 351,104 lekë ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 351,142 lekë e cila përfaqëson vlerën

neto të trojeve në administrim e pronësi të Bashkisë Kuçovë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se shtesat janë në vlerën 38 lekë që i korrespondon pronave të regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajoneve të ASHK Kuçovë, por pa vlerë, si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur.

Llogaria 211 "Pyje, Plantacione, kullota" më 31.12.2020 paraqitet me vlerë 0 lekë ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 351,142 lekë e cila përfaqëson vlerën neto të pyjeve në administrim e pronësi të Bashkisë Kuçovë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se shtesat janë në vlerën 1 lekë që i korrespondon pronave të regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajoneve të ASHK Kuçovë por pa vlerë, si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur.

Llogaria (212) "Ndërtesa e Konstruksione", më 31.12.2021 paraqitet me vlerë historike 140,424,536 lekë dhe vlerë neto 105,364,697 lekë që përfaqëson vlerën neto të ndërtesave të objekteve në administrim e pronësi të Bashkisë Kuçovë, pakësimet janë në vlerën 35,059,839 lekë për normën e amortizimit vjetor + amortizimin e akumuluar dhe blerje të krijuara me pagesë në vlerën 9,397,669 lekë. **Konstatohet se në llogarinë 212 "Ndërtesa e Konstruksione"**, janë kontabilizuar 61 objekte në vlerën 61 lekë që i korrespondon pronave të regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajoneve të ASHK Kuçovë, por pa vlerë, si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 *ōPër procedurat e pērgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitē e Qeverisjes së Pērgjithshmeō*, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabēl dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33. *(Mē hollēsisht trajtuar në pikēn 3, faqe 40-53 të Raportit Pērfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandim: Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nēpunēsit Autorizues, të marrē masa të menjēhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerēsimit të aktiveve afatgjata materiale (*ndērtesa e konstruksione*), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerē reale historike (*referuar tregut*), si dhe kryerjen e veprimeve kontabēl referuar rezultatit (*rritje/ulje rivlerēsimi*), respektivisht në llogaritē përkatēse (21) *ōAktive afatgjata materialeō* e llog.(109) *ōDiferenca nga rivlerēsimiō*.

Gjithashtu të ngrejē një grup pune me specialit të fushēs, për kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Kuçovē, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesē të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje pērgjegjēsie.

Deri më 31.10.2022

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, rezulton se llogaria (26) *ōAktive afatgjata Financiareō*, paraqitet me vlerē zero. Pasqyrimi I kēsaj llogarie është bērē në mēnyrē të gabuar pasi; Bashkia Kuçovē, në Qendrēn Kombētare të Biznesit, më 31/12/2021 paraqitet si aksionare me 34.68% të aksioneve të Ujēsjsjellēs Kanalizime Berat SHA ndērsa Bashkia Berat paraqitet me 65.32% si aksionare të aksioneve të Ujēsjsjellēs Kanalizime Berat SHA, me NUIS e cila është shoqēri aksionare me objekt *ōShērbimi i furnizimit me ujē të pijshēm i konsumatorēve dhe shitja e tij*. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerē nominale 876,860 dhe kapital në vlerē monetare prej 876,860,000 lekē. Referuar ekstraktit historik Bashkia Kuçovē zotēron 304,073 lekē/aksion dhe kapital në vlerē monetare prej 304,073,000 lekē, ose 34,68 % të aksioneve në pjesēmarrje të Bashkisë Kuçovē në *ōUjēsjsjellēs Kanalizime Berat SHA* duke sjell një nēnvlerēsim të llogarisē 26 Pjesēmarrje në kapitalet e vetaō në vlerēn 304,073,000 lekē.

Gjithashtu Bashkia Kuçovë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit N, si SH.A. me NUIS òe cila është shoqëri aksionere me objekt òOrganizimi i aktiviteteve sportive ne fushën e futbollit. Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtar dhe ndërkombëtarò. Numri i aksioneve është 3,500 me vlerë nominale 1000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3.500.000 lekë, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë 26 òPjesëmarrje në kapitalet e vetaò. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë nr. 64 datë 22.07.2014 òPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 òAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomaterialeò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 òTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 40-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandim:Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin si pjesëmarrjes 34,68 % të kapitalin me vlerë monetare 304,073,000 lekë, në òUjësjellës Kanalizime Berat SHA dhe 100% në kapitalin e aksioneve tek klub sport Nme vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llog. 26 òPjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, rezulton se **Llogaria (230; 231) “Investime”**, për (AAJM/AAM) paraqiten me vlerë 301,330,325 lekë. Nga analiza e llogarisë 231 òInvestime në procesò rezulton se për 10 objekte në vlerë 230,167,491 lekë janë investime të viteve paraardhës respektivisht të viteve 2015-2020 të cilat janë marrë në dorëzim nga ana e drejtorisë së PZHT për të cilat nuk është bërë sistemi i tyre nga llog (231) në llogarinë (213), sipas aneksit nr. 7 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshmeò dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 òPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar dhe neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 40-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandim:Drejtorja e financës të marre masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë (231) në llogaritë (213) ose (213), sipas objekteve pasi një pjesë e tyre janë mbyllur dhe duhet të kapitalizohet në aktive afatgjata materiale.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se nëstrukturën e DAV Bashkia Kuçovë janë evidentuar lëvizje të shpeshta të stafit si dhe mangësi në plotësimin e strukturës organizative me specialit respektivisht; Specialist IT për përdorimin e programit kompjuterik çka sjell mos evidentimin e subjekteve, mos llogaritjen e detyrimit fiskale për këto mos deklarime si dhe mos arkëtimin e të ardhurave, kjo për mungesë stafi, në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot. datë 07.02.2018. Gjithashtu nga Drejtorja e të Ardhurave, nuk është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, për të gjitha detyrimet tatimore dhe nuk janë vendosur në dosjen e çdo taksa paguesi, nuk është bërë përditësimi i të dhënave dhe nuk është

plotësuar dokumentacioni, ku të regjistroheshin të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit. Nuk është vepruar për të kryer inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi e konkretisht: -të gjitha praktikatat nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit; -i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë; -praktikat e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim, me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 *oPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, Neni 29 Dosja e detyrimeve tatimore, pika 1, Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 oPër arkivatë neni 24. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1.Rekomandim:Kryetari i Bashkisë Kuçovë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Kuçovë me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave.

Gjithashtu DAV Bashkia Kuçovë të marrë masa për përditësimin e të dhënave me dokumentacionin e nevojshëm, ku të regjistroheshin të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.

Deri më 31.10.2022

12.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi u konstatuan diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Për vitin 2021 plani fillestar është në vlerën 209,000 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 204,966 mijë lekë ose 98 %, sipas planit të ndryshuar mos realizim në vlerën 4,034 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit. Rezulton se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një data bazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një data bazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Kuçovë. Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë. Drejtorinë e të Ardhurave, duke mos pasur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Kuçovë (DRTB), Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Kuçovë (ASHKK) dhe Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Kuçovë (DSHTRB).

Gjithashtu Drejtorinë e të ardhurave për familjet që nuk kanë një kontratë me UK Kuçovë, nuk ka një baza e të dhënave për familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellësin përditësohet vetëm për rastet kur familjarët paraqiten pranë zyrave të bashkisë për të marrë shërbime të ndryshme. Akt rakordimet me agjentët tatimorë nuk janë mbajtur sipas formatit të përcaktuar me Udhëzim të posaçëm nga Ministria e Financave. Rakordimet janë bërë në formë proces-verbalesh, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nuk ka asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave.

Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *oPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, *oPër vetëqeverisjen vendore*, neni 64, *oKompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë*; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 *oPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore* i ndryshuar, neni 5, *oParime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*, neni 42, *oAdministrimi i mjeteve monetare*, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, *oRaportimi financiar* nën-pika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV *oProcedurat standarde për menaxhimin e të*

ardhuraveö pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 *öPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 öPër Sistemin e Taksave Vendoreö, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 öPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e një plani të pa realizueshëm në fakt.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1.Gjetje nga auditimi:Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ardhurat nga agjentët tatimorë(*Drejtoria Rajonale Tatimore Kuçovë, në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Kuçovë, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*), derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Kuçovë nuk ka krijuar bazë të plotë të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet.Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Kuçovë, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Nënin 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, öPër Procedurat Tatimoreö, ku parashikohet se *öDënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifaveö.*

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korespondencë me Ministrinë e Financave.

- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 öPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar, neni 7 öTë drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimitö dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, öPër sistemin e taksave vendoreö, i ndryshuar, neni 15 öParapagimiö, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 öPër taksat Kombëtareö. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

